



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 208

Tiranë – E mërkurë, 12 nëntor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 5.11.2025	Për përcaktimin e rregullave të inspektimit për parandalimin, reduktimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të parregulluar e të paraportuar dhe për krijimin e skemës së certifikimit të zënieve në peshkim..... 24743
Urdhër i ministrit të Arsimit nr. 563, datë 3.11.2025	Për raportimin e të dhënave dhe ecurisë së çështjeve gjyqësore..... 24787
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 1089, datë 3.11.2025	Për delegim kompetencash..... 24788
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 1090, datë 3.11.2025	Për delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi çështjet konsullore..... 24788
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 1091, datë 3.11.2025	Për delegimin e kompetencës së përfaqësimit ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore..... 24789
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1095, datë 30.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Rumanisë..... 24790
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1096, datë 30.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Hungarisë..... 24791
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1097, datë 30.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 24793

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1098, datë 30.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	24794
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1099, datë 30.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës.....	24795
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr.1100, datë 30.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Lituanisë.....	24796
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1101, datë 30.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Suedisë.....	24798
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1102, datë 30.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	24799
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1103, datë 30.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës.....	24800
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1104, datë 30.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	24801
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1105, datë 30.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Belgjikës.....	24802
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1106, datë 30.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës	24803
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1112, datë 3.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	24804
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1113, datë 3.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	24807
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1114, datë 3.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës	24808
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1115, datë 3.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	24809

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1116, datë 3.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës.....	24810
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1117, datë 3.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	24811
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1118, datë 3.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë	24812
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1119, datë 3.11.2025	Për shfuqizimin e urdhrin nr. 925, datë 25.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Argjentinës”.....	24812
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 57, datë 14.10.2025	Me objekt plotësimin e vendimit nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese.....	24813
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 258, datë 21.10.2025	Mbi njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, për subjektin “ <i>Management & Development Associates LLC</i> ”.....	24816
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 259, datë 21.10.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Prosol” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	24817
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 260, datë 21.10.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “Reytech Trading” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	24819
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 261, datë 21.10.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “Vivid Power” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	24820
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 262, datë 21.10.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “Vivid Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	24821
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 263, datë 21.10.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese të aseteve fikse të shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k.....	24822
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 264, datë 21.10.2025	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 199, datë 15.8.2025, “Për dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj ‘Procredit Bank’ sh.a.”.....	24825
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 272, datë 31.10.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “GSA Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	24826
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 273, datë 31.10.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “GSA Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike	24827

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 274, datë 31.10.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a. dhe “First Investment Bank AD” sh.a.....	24828
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 275, datë 31.10.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Age Erzen” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a.....	24830
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 721/11, datë 3.11.2025	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim depo në zonën e Qytetit të Nxënësve”, me vendndodhje Tiranë.....	24832
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 1063/5, datë 4.11.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 534, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtim rruga Porto-Romano–Durrës, loti 3’”, i ndryshuar	24833

**VENDIM****Nr. 643, datë 5.11.2025****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË INSPEKTIMIT PËR
PARANDALIMIN, REDUKTIMIN DHE
ELIMINIMIN E PESHKIMIT TË
PALIGJSHËM, TË PARREGULLUAR E
TË PARAPORTUAR DHE PËR KRIJIMIN
E SKEMËS SË CERTIFIKIMIT TË
ZËNIEVE NË PESHKIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 118, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi dhe fusha e zbatimit**

1. Ky vendim ka për qëllim vendosjen e rregullave dhe të masave të inspektimit, me synim parandalimin, reduktimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të parregulluar e të paraportuar (në vijim, peshkimi PPP), si dhe krijimin e një skeme certifikimi të zënieve për importin dhe eksportin e produkteve të peshkimit.

2. Ky vendim zbatohet për të gjitha aktivitetet e peshkimit PPP dhe të aktiviteve të lidhura me të, të kryera brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar.

Neni 2**Përkufizime**

Në zbatim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “*CATCH*”, një sistem i Bashkimit Evropian i menaxhimit të informacionit digjital të integruar me sistemin TRACES, i cili ka për qëllim shkëmbimin e informacionit, të të dhënave dhe dokumenteve në lidhje me importin, rieksporin dhe, sipas rastit, eksportin e produkteve të peshkimit dhe kontrollet

përkatëse, menaxhimin e rrezikut, hetimet e kontrollet, si dhe me dokumentet e përmendura në këtë vendim, si: deklaratat e importuesit, certifikatat e zënies, certifikatat e rieksporit, deklaratat, kërkesat ose vendimet ndërmjet importuesit, rieksporuesit dhe, sipas rastit, eksportuesit dhe autoriteteve kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe autoriteteve kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë;

2. “*Det i hapur*”, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 9055, datë 24.4.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën mbi të Drejtën e Detit’ të OKB-së”;

3. “*Dërgesë*”, produktet që dërgohen në një ngarkesë të vetme nga një eksportues tek një marrës ose që mbulohen nga një dokument i vetëm transporti, që mbulon dërgesën e tyre nga eksportuesi tek marrësi;

4. “*Import*”, futja e produkteve të peshkimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë, gjithashtu, dhe ato për qëllime transbordimi në portet shqiptare;

5. “*Import indirekt*”, import i produkteve të peshkimit nga territori i një vendi të huaj, të ndryshëm nga shteti i flamurit të anijes së peshkimit përgjegjëse për zënet;

6. “*Eksport*”, çdo lëvizje drejt vendeve të huaja të produkteve të peshkimit të zëna nga anijet e peshkimit, që lundrojnë nën flamurin shqiptar;

7. “*Leje peshkimi*”, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar;

8. “*Masa të ruajtjes dhe të menaxhimit*”, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar;

9. “*Menaxhim i rrezikut*”, identifikim sistematik i rrezikut dhe zbatimi i të gjitha masave të nevojshme për kufizimin e ekspozimit ndaj tij. Kjo përfshin veprimtari, si: mbledhjen e të dhënave dhe të informacionit, analizimin e vlerësimit të rrezikut, përcaktimin dhe ndërmarrjen e veprimeve përkatëse, si dhe monitorimin e rishikimin e rregullt të procesit dhe të rezultateve të tij, duke u bazuar në burime ose strategji kombëtare e ndërkombëtare;

10. “*Ministria*”, ministria përgjegjëse për peshkimin;

11. “*Ministër*”, ministri përgjegjës për peshkimin;



12. “Organizata Rajonale e Menaxhimit të Peshkimit”, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar;

13. “Palë kontraktuese”, një palë kontraktuese e konventës ose e marrëveshjes ndërkombëtare, që krijon një organizatë rajonale të menaxhimit të peshkimit, si dhe shtetet, subjektet e peshkimit ose çdo subjekt tjetër, që bashkëpunon me një organizatë të tillë dhe i është dhënë statusi i palës bashkëpunuese;

14. “Operacion i përbashkët peshkimi”, çdo operacion ndërmjet dy ose më shumë anijeve të peshkimit, ku zëniet transferohen nga veglat e peshkimit të një anijeje në tjetrën ose kur teknika e përdorur nga ato anije peshkimi kërkon një vegël të përbashkët peshkimi;

15. “Peshkimi i paligjshëm, i paraportuar dhe i parregulluar” ose “peshkimi PPP”, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar;

16. “Pikasje”, çdo shikim nga distanca nga inspektorati përgjegjës për peshkimin dhe çdo autoritet tjetër, përgjegjës për inspektimet në det ose nga kapiteni i një anijeje peshkimi vendase, ose të huaj;

17. “Person juridik”, çdo subjekt që ka një status të tillë, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të organeve publike, në ushtrimin e autoritetit shtetëror;

18. “Produkt peshkimi”, çdo produkt që përfshihet nën kapitullin 03 dhe krerët tariforë 1604 dhe 1605 të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave, të miratuar në legjislacionin në fuqi për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave, me përjashtim të produkteve të listuara në aneksin I të këtij vendimi;

19. “QNOD”, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare;

20. “Riekспорт”, çdo lëvizje nga territori i Republikës së Shqipërisë i produkteve të peshkimit, të cilat ishin importuar më parë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

21. “Rrezik”, mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje në lidhje me produktet e peshkimit, që importohen ose eksportohen nga/ose në territori/n i/e Republikës së Shqipërisë, e cila mund të pengojë zbatimin e dispozitave të këtij vendimi ose të masave për ruajtjen e menaxhimit të peshkimit;

22. “Transbordimi”, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar.

KREU II

INSPEKTIMI I ANIJEVE TË PESHKIMIT NË PORTE

Neni 3

Inspektimi portual

1. Rregullat e inspektimit në port zbatohen për anijet e peshkimit me flamur të huaj, që hyjnë në portet shqiptare me synimin për të parandaluar, reduktuar dhe eliminuar peshkimin PPP.

2. Anijeve me flamur të huaj, që nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara nga ky vendim, u ndalohej hyrja në portet shqiptare, përfitimi nga shërbimet portuale, si dhe kryerja e operacioneve të zbarkimit, transbordimit në këto porte, me përjashtim të rasteve të forcës madhore, sipas Konventës mbi të Drejtën e Detit, miratuar me ligjin nr. 9055, datë 24.4.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën mbi të Drejtën e Detit’ të OKB-së”.

3. Të gjitha operacionet e transbordimit janë të ndaluara ndërmjet anijeve shqiptare të peshkimit dhe anijeve me flamur të huaj në ujërat territoriale shqiptare. Këto operacione lejohen në port, vetëm në përputhje me rregullat e këtij kreu.

4. Anijeve të peshkimit me flamur shqiptar nuk u lejohet të transbordojnë në det, jashtë ujërave territoriale shqiptare, zëniet e kryera nga anije me flamur të huaj, me përjashtim të rasteve kur anijet me flamur të huaj janë të regjistruara si anije transporti pranë një organizate rajonale të menaxhimit të peshkimit.

Neni 4

Portet e përcaktuara

1. Anijet e peshkimit me flamur të huaj kanë akses në shërbime ose të kryejnë operacione zbarkimi vetëm në portet e përcaktuara sipas nenit 98, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar.

2. Ministria ia njofton Komisionit Evropian, jo më vonë se data 15 janar e çdo viti, një listë të porteve të përcaktuara. Çdo ndryshim i mëvonshëm në këtë listë i njoftohet Komisionit Evropian të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara se ndryshimi të hyjë në fuqi.

3. Ministria publikon listën e porteve të përcaktuara në faqen e saj zyrtare të internetit.



Neni 5

Njoftimi paraprak

1. Kapitenët e anijeve të peshkimit me flamur të huaj ose përfaqësuesit e tyre njoftojnë paraprakisht Drejtorinë e Përgjithshme Detare, jo më vonë se 3 (tri) ditë para kohës së parashikuar për mbërritjen në port. Njoftimi përmban informacionet e mëposhtme:

- a) të dhënat për identifikimin e anijes;
- b) emrin e portit të përcaktuar si destinacion dhe qëllimin e mbërritjes në port, të zbarkimit, të transbordimit ose të përfitimit të shërbimeve;
- c) autorizimin/lejen e peshkimit ose, sipas rastit, autorizimin për të mbështetur operacionet e peshkimit ose të transbordimit të prodhimeve të peshkimit;
- ç) datën dhe orën e parashikuar për mbërritje në port;
- d) datat e zënieve të prodhimeve të peshkimit;
- dh) të dhënat për sasitë për secilin lloj të mbajtur në bord ose, sipas rastit, kur nuk ka të tillë, një relacion negativ;
- e) të dhënat për zonën ose zonat, në të cilën/at janë kryer zëniet ose transbordimet (ujërat shqiptare ose zonat ujore nën juridiksionin e vendeve të huaja ose në det të hapur);
- ë) të dhënat për sasitë që do të zbarkohen ose do të transbordohen për çdo lloj.

2. Kapitenët e anijeve të peshkimit me flamur shqiptar ose përfaqësuesit e tyre njoftojnë paraprakisht autoritetet përgjegjëse të vendit anëtar të Bashkimit Evropian të porteve të përcaktuara, që kanë qëllim të përdorin, jo më vonë se 3 (tri) ditë pune, përpara kohës së parashikuar për mbërritjen në port, informacionet sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Njoftimi paraprak kryhet sipas modelit të përcaktuar në shtojcën II A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe, në rast se zëniet janë të shoqëruara me një certifikatë zënieje, njoftimi bëhet sipas formatit të parashikuar në shtojcën II B, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kapitenët e anijeve të peshkimit me flamur të huaj dhe kapitenët e anijeve shqiptare të peshkimit ose përfaqësuesit e tyre përjashtohen nga detyrimi i njoftimit të informacionit, sipas pikave 1, shkronjat: “a”, “c”, “d”, “e” e “ë”, dhe 2, të këtij neni, në rastet kur certifikatës së zënieve i është dhënë vlefshmëria, sipas kreut III të këtij vendimi, për të gjitha zëniet që

do të zbarkojnë ose do të transbordojnë në territorin shqiptar ose të Bashkimit Evropian.

5. Nëse një anije peshkimi shqiptare ose me flamur të huaj mban në bord produkte peshkimi, njoftimi, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, shoqërohet nga një certifikatë zëniesh, që ka marrë vlefshmërinë sipas kreut III të këtij vendimi. Rregullat, sipas neneve 13 e 15 të këtij vendimi, zbatohen në portet shqiptare dhe të vendeve të Bashkimit Evropian, sipas certifikatave të zënies ose të mënyrës së kontrollit, pjesë në sistemet e dokumentimit të zënieve ose të kontrollit në porte, të miratuara nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit përkatëse. Ministri përjashton disa kategori të anijeve të peshkimit me flamur të huaj ose shqiptare nga detyrimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni për një periudhë kohe të kufizuar e të rinovueshme ose parashikon një periudhë tjetër njoftimi, duke marrë parasysh, ndër të tjera, llojin e produktit të peshkimit, distancën ndërmjet zonave të peshkimit, vendeve të zbarkimit dhe porteve, ku janë të regjistruara ose të listuara anijet në fjalë.

6. Ky nen zbatohet pa prekur dispozitat e veçanta të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare të peshkimit, në të cilat është palë Republika e Shqipërisë.

Neni 6

Autorizimet

1. Me përjashtim të shkronjës “d”, të nenit 39, të këtij vendimi, anijet e peshkimit shqiptare hyjnë në portet e vendeve të Bashkimit Evropian dhe anijet e peshkimit me flamur të huaj hyjnë në portet shqiptare, vetëm në rast se informacionet, sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 5, të këtij vendimi, janë të plota, si dhe kur anijet e peshkimit kanë në bord produkte peshkimi, që janë të shoqëruara nga certifikatat e zënies, sipas pikës 3, të nenit 5, të këtij vendimi.

2. Autorizimi për të filluar veprimet e zbarkimit dhe të transbordimit jepet pas një kontrolli, që ka për qëllim verifikimin e të gjithë dokumentacionit të paraqitur sipas pikës 1 të këtij neni dhe sipas modaliteteve të parashikuara në këtë kre.

3. Si përjashtim të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme Detare, pas njoftimit të inspektorit përgjegjës të kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë në pikat e inspektimit kufitar (në vijim, PIK), autorizon hyrjen në port dhe zbarkimin



e një pjese ose të të gjitha zënieve edhe në rast se informacioni i kërkuar nga pika 1, e nenit 5, të këtij vendimi, nuk është i plotë ose kur kontrolli dhe verifikimi i këtij dokumentacioni nga inspektorati përgjegjës për peshkimin është akoma në proces, me kusht që produktet e peshkimit të ruhen në magazinat doganore, nën kontrollin e institucionit përgjegjës të kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë në PIK. Produktet e peshkimit hidhen në treg, merren në dorëzim ose transportohen vetëm pas sigurimit të të gjithë informacionit, sipas pikës 1, të nenit 5, të këtij vendimi, ose, kur kryhet kontroll, pas përfundimit të kontrollit dhe të verifikimit. Nëse kjo procedurë zgjat më shumë se 14 (katërmëdhjetë) ditë, inspektorati përgjegjës për peshkimin, sipas kësaj pike konfiskon dhe vendos asgjësimin e produkteve të peshkimit. Kostoja e magazinimit dhe e eliminimit është në ngarkim të subjektit. Eliminimi i produkteve të peshkimit bëhet nga subjekti, sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin e mjedisit.

Neni 7

Regjistrimi i operacioneve të zbarkimit ose të transbordimit

1. Kapitenët e anijeve të peshkimit me flamur të huaj ose përfaqësuesit e tyre paraqesin, në rrugë elektronike, te inspektorati përgjegjës për peshkimin, dhe përpara se të fillojnë veprimet e zbarkimit e të transbordimit, një deklaratë, me anë të së cilës tregohet sasia e produkteve të peshkimit për çdo lloj që do të zbarkohet ose transbordohet, si dhe data e vendi i zënies për secilin lloj. Kapitenët ose përfaqësuesit e anijeve janë përgjegjës për saktësinë e kësaj deklarate.

I njëjti rregull vlen edhe për anijet shqiptare të peshkimit, që synojnë të përdorin portet e një vendi tjetër, të cilat e paraqesin këtë deklaratë tek autoritetet kompetente të atij vendi.

2. Inspektorati përgjegjës për peshkimin i dërgon deklaratat origjinale në ministri, e cila i ruan sipas rregullave të legjislacionit në fuqi për arkivat.

3. Deklarata paraprake e zbarkimit dhe e transbordimit bëhet sipas formatit të përcaktuar në shtojcat III A dhe III B, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Një anije peshkimi me flamur shqiptar paraqet deklaratën paraprake të zbarkimit ose të transbordimit në format elektronik, nëse shteti

anëtar i Bashkimit Evropian dhe ministria kanë rënë dakord për shkëmbimin elektronik të të dhënave.

5. Nëse nuk është rënë dakord, sipas pikës 4 të këtij neni, anijet e peshkimit shqiptare paraqesin deklaratën paraprake të zbarkimit ose të transbordimit:

a) në gjuhën zyrtare të shtetit anëtar të zbarkimit ose të transbordimit; ose

b) në gjuhën angleze, me pëlqimin paraprak të shtetit anëtar të zbarkimit ose të transbordimit.

6. Deklarata paraprake e zbarkimit ose e transbordimit paraqitet të paktën 4 (katër) orë përpara kohës së planifikuar të zbarkimit ose të transbordimit.

Neni 8

Rregullat që zbatohen gjatë inspektimit në port

1. Inspektorati përgjegjës për peshkimin kryen inspektime të anijeve me flamur të huaj në portet e përcaktuara, në së paku 5% të veprimeve të zbarkimit e të transbordimit që kryhen në një vit, në përputhje me parametrat e përcaktuar me urdhër ministri, në bazë të menaxhimit të rrezikut, me përjashtim të rasteve kur janë përcaktuar nivele më të larta inspektimi nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit.

2. I nënshtrohen, inspektimit, në çdo rast anijet e peshkimit:

a) të pikasura sipas neneve 45 dhe 46 të këtij vendimi;

b) të sinjalizuara nga sistemi alert i Bashkimit Evropian, sipas kreut IV të këtij vendimi;

c) për të cilat mendohet se kanë kryer peshkim PPP, sipas nenit 28 të këtij vendimi;

ç) që rezultojnë në listën PPP të miratuar nga një organizatë rajonale e menaxhimit të peshkimit, sipas nenit 32 të këtij vendimi.

3. Inspektorët që mbulojnë peshkimin kanë të drejtë të inspektojnë të gjitha zonat, urat dhe mjediset e anijes së peshkimit, zënie të përpunuara ose jo, rrjetat dhe veglat e tjera të peshkimit, si dhe të gjithë dokumentacionin, që vlerësojnë të nevojshëm, për të verifikuar respektimin e ligjeve, rregulloreve dhe masave ndërkombëtare të menaxhimit e të mbrojtjes, të zbatueshme në këto raste. Inspektorët mund të pyesin cilindo që mendohet se ka informacion në lidhje me objektin e inspektimit.



4. Inspektimet përfshijnë të gjitha operacionet e zbarkimit dhe të transbordimit, si dhe kontrollin e kryqëzuar ndërmjet sasive të treguara në njoftimin paraprak të zbarkimit dhe sasive të zbarkuara ose të transborduara.

5. Inspektorët nënshkruajnë aktin e inspektimit në prani të kapitenit të anijes së peshkimit, i cili ka të drejtën të bëjë të gjitha shënimet që mendon se lidhen me inspektimin. Inspektorët shënojnë në librin e anijes inspektimin që është kryer.

6. Kopje e aktit të inspektimit i dorëzohet kapitenit të anijes, i cili mund t'ia dorëzojë edhe pronarit. Kapiteni i anijes së peshkimit bashkëpunon dhe ndihmon gjatë inspektimit të anijes dhe nuk pengon, kërcënon ose ndërhyr në punën e inspektorit gjatë kryerjes së detyrës.

Neni 9

Procedura e inspektimit

Me qëllim verifikimin e respektimit të legjislacionit kombëtar dhe të masave menaxhuese ndërkombëtare të ruajtjes, zbatohen dispozitat e neneve 121 dhe 122, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, dhe të ligjit për inspektimin në fuqi, në Republikën e Shqipërisë.

Neni 10

Procedura e zbatueshme në rast shkeljeje

1. Nëse informacionet e grumbulluara gjatë inspektimit përmbajnë elemente të provës, që çojnë në përfundimin se një anije peshkimi ka kryer peshkim PPP, inspektor:

a) vendos shkeljen e dyshuar në aktin e inspektimit;

b) merr të gjitha masat e nevojshme për të garantuar ruajtjen dhe sigurimin e elementeve të provës në lidhje me shkeljen e dyshuar;

c) dërgon menjëherë aktin e inspektimit në drejtorinë përgjegjëse për peshkimin në ministri.

2. Nëse inspektimi jep elemente të provës se një anije peshkimi me flamur të huaj ka zhvilluar peshkim PPP, inspektorati përgjegjës për peshkimin ndalon këtë anije të kryejë zbarkimin ose transbordimin e zënieve.

3. Inspektorati përgjegjës për peshkimin njofton menjëherë ministrinë për vendimin e tij për të mos lejuar operacionet e zbarkimit ose të transbordimit të ndërmarra, sipas pikës 2 të këtij neni, të shoqëruar

me një kopje të aktit të inspektimit. Ministria ia transmeton këtë njoftim menjëherë autoritetit kompetent të shtetit, flamurin e të cilit mban anija e peshkimit të inspektuar, dhe një kopje shtetit ose shteteve flamur të anijeve dhënëse, në rast se anija e peshkimit e inspektuar ka kryer operacione të transbordimit. Në rast se është e nevojshme, një kopje e njoftimit i dërgohet edhe sekretarit ekzekutiv të organizatës rajonale të menaxhimit të peshkimit në zonën e përgjegjësisë, ku janë kryer zëniet.

4. Nëse shkelja e supozuar është kryer në det të hapur, inspektorati përgjegjës për peshkimin bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të shtetit, flamurin e të cilit mban anija, për të hetuar me tej mbi shkeljen dhe, nëse është rasti, zbaton legjislacionin shqiptar.

Gjithashtu, nëse shkelja e supozuar është kryer në ujërat e një shteti tjetër, inspektorati përgjegjës për peshkimin bashkëpunon me autoritetin përgjegjës të shtetit bregdetar për kryerjen e hetimit dhe, sipas rastit, zbaton sanksionet e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

KREU III

SISTEMI I CERTIFIKIMIT TË ZËNIEVE PËR PRODHIMET E PESHKIMIT

Neni 11

Certifikata e zënieve

1. Me qëllim parandalimin e produkteve të peshkimit të përfituara nga peshkimi PPP, produktet e peshkimit importohen dhe eksportohen vetëm kur ato janë të shoqëruara nga një certifikatë zënije, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

2. Certifikata e zënieve merr vlefshmëri pas vulosjes së saj nga inspektorati përgjegjës për peshkimin në portin përkatës të anijes së peshkimit, që ka kryer zëniet peshkore, në rastin e eksportit të produkteve shqiptare.

3. Certifikata e zënieve vërteton se zëniet janë kryer në përputhje me rregullat dhe masat menaxhuese e mbrojtëse kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi. Certifikata e zënies për produktet peshkore të importuara e merr vlefshmërinë nga autoriteti përgjegjës i vendit eksportues, i përcaktuar në shtojcën IX, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Inspektorati i portit përkatës i anijes së peshkimit, e cila ka kryer zëniet, dërgon brenda 24



(njëzet e katër) orëve në ministri, një kopje të certifikatës, si dhe dokumentacionin përkatës (libri i zënies, certifikata e trasbordimit), në format elektronik/të printuar.

5. Certifikata e zënieve plotësohet në katër kopje, nga të cilat njëra shoqëron produktet e peshkimit, njëra mbahet nga inspektorati përgjegjës për peshkimin, njëra mbahet nga subjekti eksportues dhe njëra dërgohet në ministri. Inspektorati përgjegjës për peshkimin në port, pas vulosjes së certifikatave të zënieve, krijon një regjistër për certifikatat e vulosura prej tij.

6. Certifikata përmban të gjithë informacionin e specifikuar në modelin e paraqitur në shtojcën IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe i jepet vlefshmëria nga inspektorati përgjegjës për peshkimin, që ka kompetencën për të kontrolluar vërtetësinë e informacionit. Certifikata e zënieve bazohet në të dhënat e plotësuara nga libri i anijes së peshkimit, që ka kryer zëniet, nga të cilat janë përfituar produktet e peshkimit. Në marrëveshje apo në kuadër të bashkëpunimit me vendet e Bashkimit Evropian ose vende të tjera, certifikata e zënieve hartohet, i jepet vlefshmëria, paraqitet në rrugë elektronike apo zëvendësohet nga sisteme të gjurmueshmërisë elektronike, duke siguruar të njëjtin nivel kontrolli nga autoritetet përkatëse.

7. Lista e produkteve të peshkimit të paraqitura në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, që përjashtohet nga qëllimi i zbatimit të certifikatës së zënieve, rishikohet nga ministria, bazuar mbi ndryshimet e bëra nga Komisioni Evropian.

Neni 12

Certifikata e thjeshtuar e zënieve

1. Ky nen zbatohet për anijet e peshkimit me flamur të huaj dhe anijet me flamur shqiptar, prodhimet e të cilave kanë për qëllim eksportin në Shqipëri dhe vendet e Bashkimit Evropian, respektivisht, si më poshtë:

- a) me një gjatësi të përgjithshme më të vogël se 12 (dymbëdhjetë) metra pa vegla tërheqëse; ose
- b) me një gjatësi të përgjithshme më të vogël se 8 (tetë) metra me vegla tërheqëse; ose
- c) pa superstrukturë; ose
- ç) të një tonazhi më të vogël se 20 GT.

2. Zëniet e kryera nga anijet, sipas pikës 1 të këtij neni, të zbarkuara vetëm në shtetin, flamurin e të cilit mbajnë këto anije, dhe që përbëjnë një pjesë të një

ngarkese të vetme, shoqërohen nga një certifikatë e thjeshtuar e zënies në vend të certifikatës së peshkimit, të përcaktuar në nenin 11 të këtij vendimi. Certifikata e thjeshtuar e zënies përmban të gjithë informacionin e treguar në modelin e përcaktuar në shtojcën V të këtij vendimi dhe vërtetohet nga një nga autoritetet publike të shtetit, flamurin e të cilit mban anija, autorizuar për të certifikuar saktësinë e informacionit, dhe inspektorati përgjegjës për peshkimin, në rastin e anijeve shqiptare.

3. Vlefshmëria e certifikatës së thjeshtuar të zënieve kërkohet nga eksportuesi i ngarkesës pas paraqitjes pranë autoritetit publik përkatës, sipas pikës 2 të këtij neni, të të gjithë informacionit të kërkuar në formatin e përcaktuar në shtojcën V të këtij vendimi.

Neni 13

Dokumentacioni i peshkimit, i miratuar dhe i zbatuar nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit

1. Dokumentet e zënies dhe çdo dokument që lidhet me to, të cilave u është dhënë vlefshmëri, në përputhje me skemat e dokumentacionit të zënieve të miratuara nga një organizatë rajonale e menaxhimit të peshkimit dhe që janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë vendim, pranohen si certifikata zënije për produktet e peshkimit për speciet, për të cilat këto skema u nënshtrohen detyrimeve të kontrollit dhe verifikimit nga shteti importues Shqipëria ose shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, në përputhje me nenet 17, 18 dhe 20 të këtij vendimi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet pa cenuar rregullat e përcaktuara në këtë vendim dhe të legjislacionit për peshkimin në fuqi.

3. Skemat e dokumentimit të zënieve të miratuara nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit, të listuara në pjesët I dhe II, të shtojcës V, të këtij vendimi, zbatohen për qëllimet e pikës 1 të këtij neni.

Neni 14

Sistemi i integruar i menaxhimit të informacionit për sistemin e certifikimit të zënieve

1. Çdo eksportues i produkteve të peshkimit dhe autoritetet kompetente të përcaktuara në këtë vendim përdorin sistemin *CATCH*.



2. Fillimi i përdorimit të sistemit *CATCH* përcaktohet me urdhër ministri.

Neni 15

Rieksporti dhe importi i produkteve të peshkimit

1. Në mënyrë që të rieksportohen nga Shqipëria produkte peshkimi, të peshkuara nga anije me flamur të huaj ose e ndryshme nga shteti, në të cilin kryhet përpunimi i zënieve, i përmendur në pikën 3 të këtij neni, eksportuesi paraqet pranë autoriteteve kompetente të vendit importues:

a) certifikatën e zënies, që ka marrë vlefshmërinë nga shteti, flamurin e të cilit anija mban, ose deklaratën e përmendur në pikën 4 të këtij neni, si më poshtë:

i. certifikatën origjinale të zënies ose origjinalin e deklaratës së përmendur në pikën 4 të këtij neni, në lidhje me produktet e peshkimit në fjalë, në rast të eksportit të të gjithë ngarkesës; ose

ii. një kopje të certifikatës origjinale të peshkimit ose një kopje të deklaratës së përmendur në pikën 4 të këtij neni, kur vetëm një pjesë e produkteve të peshkimit ndodhen në ngarkesën e eksportit në fjalë; dhe

b) evidencat e dokumentuara që produkti i peshkimit nuk u është nënshtruar aktiviteteve të tjera, përveç shkarkimit dhe ringarkimit apo ndonjë aktiviteti tjetër, që shërben për ta ruajtur atë në gjendjen e mirë fillestare dhe që ka qëndruar nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore shqiptare. Përbëjnë prova të dokumentuara:

i. kur e gjithë ngarkesa e një certifikate zënieje ose deklarata e përmendur në pikën 4 të këtij neni eksportohet, dokumenti i vetëm i transportit i lëshuar për transport nëpërmjet Republikës së Shqipërisë nga territori i shtetit, flamurin e të cilit mban anija ose i shtetit, në të cilin ndodh transformimi; ose

ii. kur ngarkesa origjinale e një certifikate zënieje ose deklarata e përmendur në pikën 4 të këtij neni është ndarë, një dokument i vërtetuar nga autoritetet doganore dhe institucioni përgjegjës për inspektimin dhe kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, sipas shtojcave I, II dhe III të këtij vendimi, që të paktën përmban një përshkrim të saktë të produkteve të peshkimit, si dhe peshën e ngarkesës së eksportuar, datën e shkarkimit dhe të ringarkimit të produkteve të peshkimit ose emrin e anijeve të

peshkimit, ose të mjeteve të tjera të transportit të përdorura e të tregojë emrin dhe numrin e miratimit të objektit të magazinimit dhe kushtet, në të cilat produktet e peshkimit mbetën në atë shtet.

2. Kur këto produkte peshkimi i nënshtrohen dhe një skeme të dokumentimit të zënieve të një organizate rajonale të menaxhimit të peshkimit, dokumentet e përmendura në pikën 1 të këtij neni mund të zëvendësohen me certifikatat e rieksportit të kësaj skeme të dokumentimit të zënieve, duke pasur parasysh që vendi i origjinës së produkteve të peshkimit t'i ketë plotësuar afatet e njoftimeve në kohë.

3. E njëjta skemë certifikimi zbatohet edhe për importin e produkteve të peshkimit, që përbëjnë një dërgesë të vetme, të transportuara të papërpunuara në Shqipëri dhe për prodhimet që vijnë nga një shtet që nuk është shteti, flamurin e të cilit mban anija e peshkimit. Në këtë rast, importuesi paraqet dokumentacionin, sipas pikës 1 të këtij neni, tek inspektorati përgjegjës për peshkimin.

4. Për eksportin e produkteve të peshkut, që janë pjesë e një ngarkese të vetme dhe të përpunuara në Republikën e Shqipërisë, ku zëniet janë realizuar nga anije me flamur shqiptar ose nga anije me flamur të huaj, eksportuesi dorëzon pranë autoriteteve kompetente të shtetit importues një deklaratë të hartuar nga stabilimenti përpunues në Shqipëri dhe të miratuar nga institucioni përgjegjës për inspektimin dhe kontrollin e ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, në përputhje me formularin e përcaktuar në shtojcën VI, e cila:

a) përmban një përshkrim të saktë të produkteve të përpunuara dhe të papërpunuara dhe tregon sasitë përkatëse;

b) të tregojë se produktet janë përpunuar në Republikën e Shqipërisë nga zënie të shoqëruara me certifikatën/at e zënieve të vlefshme nga shteti i flamurit; dhe

c) të shoqëruara me:

i. certifikatën/at origjinale e/të zënies, ku të gjitha zëniet në fjalë janë përdorur për përpunimin e produkteve të peshkimit të eksportuara në një ngarkesë të vetme; ose

ii. një kopje të certifikatës/eve origjinale të zënieve, ku një pjesë e zënieve në fjalë është përdorur për përpunimin e produkteve të peshkimit të eksportuara në një ngarkesë të vetme.

5. Kur produktet e peshkimit në fjalë i nënshtrohen dhe një skeme të dokumentimit të



zën timer të një organizate rajonale të menaxhimit të peshkimit, e cila është e njohur në përputhje me pikën 1, të nenit 13, të këtij vendimi, dokumentet e përmendura nga pika 1 deri në pikën 4 të këtij neni mund të zëvendësohen me certifikatat e rieksporit të kësaj skeme të dokumentimit të zën timer, duke pasur parasysh që vendi i origjinës t'i ketë plotësuar afatet e njoftimeve në kohë.

E njëjta skemë certifikimi vlen edhe për importin e prodhimeve të peshkimit në Shqipëri, të cilat përbëjnë një dërgesë të vetme, të përpunuara në një shtet që nuk është shteti, flamurin e të cilit mban anija e peshkimit. Në këtë rast, importuesi paraqet dokumentacionin, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, tek inspektorati përgjegjës për peshkimin.

6. Dokumentet dhe deklarata e parashikuara përkatësisht në pikat 1, shkronja "b", dhe 4, të këtij neni, mund të komunikohen në rrugë elektronike brenda kuadrit të bashkëpunimit me vendet e Bashkimit Evropian.

Neni 16

Eksporti i zën timer të bëra nga anijet e peshkimit me flamur shqiptar

1. Eksporti i zën timer nga anijet e peshkimit me flamur shqiptar i nënshtrohet verifikimit nga inspektorati përgjegjës për peshkimin dhe anijet pajisen me certifikatë zën timer, në përputhje me pikën 6, të nenit 11, të këtij vendimi, dhe, nëse kërkohet, brenda kornizës së bashkëpunimit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 22, të këtij vendimi.

2. Ministria njofton Komisionin Evropian për autoritetin kompetent të ngarkuar për dhënien e vlefshmërisë së certifikatave të zën timer të peshkimit të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 17

Paraqitja dhe kontrollet e certifikatave të zën timer

1. Eksportuesi i produkteve të peshkimit në Bashkimin Evropian dorëzon certifikatën e zën timer, siç përcaktohet në pikën 6, të nenit 11, të këtij vendimi, së bashku me detajet e transportit të tyre, siç specifikohet në shtojcën IV A, bashkëlidhur këtij vendimi, deklaratën e stabilimentit të përpunimit, siç përcaktohet në pikën 4, të nenit 15, të këtij vendimi, dhe informacione të tjera, siç kërkohet në nenet 11, 15 e 18 të këtij vendimi, në rrugë elektronike

nëpërmjet sistemit *CATCH* tek autoritetet kompetente të shtetit anëtar, në të cilin synohen të eksportohen.

Certifikata e vlefshme e zën timer paraqitet nga eksportuesi të paktën 3 (tri) dite pune para kohës së parashikuara të mbërritjes tek:

a) autoritetet kompetente të shtetit anëtar, në të cilin produkti synohet të importohet në pikën e hyrjes në territorin e Bashkimit Evropian;

b) pikat e inspektimit kufitar shqiptar në pikën e hyrjes në territorin shqiptar.

Afati kohor prej 3 (tri) ditësh pune, ndryshohet duke konsideruar llojin e produktit peshkor, distancën e pikës së hyrjes në territorin e vendeve të Bashkimit Evropian ose shqiptar apo mjetet e transportit të përdorura sipas shtojcës IV A bashkëlidhur këtij vendimi. Autoritetet, sipas shkronjave "a" dhe "b", të kësaj pike, kontrollojnë certifikatat e zën timer, në bazë të menaxhimit të rrezikut për përmbajtjen e tyre dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenet 22 e 24 të këtij vendimi.

2. Si përjashtim i pikës 1 të këtij neni, importuesit, të cilëve u është dhënë statusi i Operatorit Ekonomik të Autorizuar, mund të njoftojnë inspektoratin përgjegjës për peshkimin për mbërritjen e produkteve brenda afatit të përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe të mbajnë certifikatën e zën timer dhe dokumentet e lidhura me to, të përmendura në nenin 11 të këtij vendimi, në dispozicion të inspektoratit përgjegjës për peshkimin, për qëllime të kontroleve, në përputhje me pikën 1 të këtij neni ose të verifikimeve, në përputhje me nenin 18 të këtij vendimi.

3. Kriteret për dhënien e statusit të Operatorit Ekonomik të Autorizuar një importuesi nga autoritetet doganore janë të përcaktuara sipas dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

4. Si përjashtim i pikës 1 të këtij neni, paraqitja e certifikatave të zën timer për importet e ngarkesave të produkteve të peshkimit të transportuara me mjetet e transportit, sipas shtojcës IV B të këtij vendimi, u nënshtrohet afateve më të shkurtra të përcaktuara në të njëjtën shtojcë.

Neni 18

Verifikimet

1. Ministria kryen të gjitha verifikimet për zbatimin e dispozitave të këtij vendimi.



2. Verifikimet kryhen në mënyrë të veçantë në ekzaminimin e prodhimeve, të të dhënave në deklaratat dhe të vërtetësisë së dokumentacionit, në inspektimin e mjeteve të transportit, përfshirë kontejnerët, në inspektimin e vendeve të magazinimit, sikurse në rastet e hetimeve zyrtare, si dhe në rastet e inspektimeve të anijeve të peshkimit në port, sipas kreut II të këtij vendimi.

3. Verifikimi përqendrohet drejt identifikimit të rrezikut në bazë të kriterëve të hartuara në nivel kombëtar apo në nivel të Bashkimit Evropian për menaxhimin e rrezikut.

4. Autoritetet, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 15, të këtij vendimi, kryejnë verifikimet, në rast se:

a) ka dyshime për origjinalitetin e certifikatave të zënies, të vulave ose të firmave që u japin vlefshmërinë;

b) ka informacione që vënë në dyshim ligjshmërinë e anijes së peshkimit në zbatimin e legjislacionit e të masave mbrojtëse e menaxhuese ose në zbatimin e këtij vendimi;

c) një anije peshkimi, një ndërmarrje peshkimi ose operatorë të tjerë janë sinjalizuar për peshkim PPP, përfshirë edhe anijet e sinjalizuara nga një organizatë rajonale e menaxhimit të peshkimit, në kuadër të masave të miratuara nga kjo organizatë për krijimin e listave të anijeve të përfshira në peshkim të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar (PPP);

ç) një shtet, flamurin e të cilit anija mban ose një vend rieksportues është sinjalizuar nga një organizatë rajonale e menaxhimit të peshkimit, në kuadrin e masave tregtare të miratuara nga kjo organizatë kundrejt shteteve, flamurin e të cilave mban anija;

d) është publikuar një sinjalizim, sipas nenit 25 të këtij vendimi.

5. Përveç sa është parashikuar në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, verifikime mund të kryhen edhe në mënyrë të rastësishme.

6. Për të kryer verifikimet, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të Bashkimit Evropian dhe ministria mund të kërkojnë asistencën e ndërsjellë ose të autoriteteve kompetente të një vendi të tretë, të ndryshëm nga shteti flamur, siç është parashikuar në nenin 15 të këtij vendimi. Në këto raste:

a) kërkesa për ndihmë përmban arsyet se përse autoritetet kompetente të shtetit anëtar të Bashkimit Evropian në fjalë ose ministria kanë dyshime të

bazuara për vlefshmërinë e certifikatës, të deklarimeve që përmban ajo dhe/ose të pajtueshmërisë së produkteve me masat menaxhuese dhe konservuese. Në mbështetje të kërkesës për ndihmë dërgohet një kopje e certifikatës së zënies, si dhe çdo informacion apo dokument, në bazë të të cilit sugjerohet se informacioni në certifikatë është i pasaktë. Kërkesa do t’u dërgohet menjëherë autoriteteve kompetente të shtetit, flamurin e të cilit mban anija ose të një vendi të tretë të ndryshëm nga shteti i flamurit të përmendur në nenin 15 të këtij vendimi;

b) procedura e verifikimit plotësohet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për verifikim. Në rast se ministria dhe autoritetet kompetente të shtetit anëtar të Bashkimit Evropian në fjalë ose të vendit të tretë flamur, sipas nenit 15 të këtij vendimi, nuk mund t’u përmbahen afateve dhe pas një kërkesë të bërë nga secila palë, mund të akordohet një zgjatje e afatit të përgjigjes, por kjo zgjatje nuk është më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë të tjera.

7. Hedhja e produkteve në treg pezullohet në pritje të rezultateve deri në përfundim të procedurave të verifikimit. Kostot e magazinimit përballohen nga operatori.

8. Ministria njofton Komisionin Evropian dhe autoritetet kompetente për kontrollin e verifikimin e certifikatave të zënies, sipas nenit 17 të këtij vendimi dhe të pikave 1 deri 6 të këtij neni.

Neni 19

Kriteret për verifikim

Kontrollet që synojnë zbatimin e dispozitave të këtij vendimi fokusohen në rreziqet e identifikuara në bazë të kriterëve të mëposhtme:

a) importi, eksporti ose tregtimi i produkteve të peshkimit të përfutuara nga specie me vlerë të lartë tregtare;

b) futja e llojeve të reja të produkteve të peshkimit ose zbulimi i flukseve të reja tregtare;

c) mospërputhjet ndërmjet modeleve të tregtisë dhe aktiviteteve të njohura të peshkimit të një shteti flamur, veçanërisht për sa u përket specieve, sasive ose karakteristikave të flotës së tij të peshkimit;

ç) mospërputhjet ndërmjet modeleve tregtare dhe aktiviteteve të njohura të një vendi të tretë në sektorin e peshkimit, veçanërisht në lidhje me



karakteristikat e industrisë përpunuese ose tregtisë së produkteve të peshkut të atij vendi të tretë;

d) flukset tregtare të pajustificuara në bazë të kriterëve ekonomike;

dh) pjesëmarrja e një operatori të ri;

e) rritje e papritur e konsiderueshme në vëllimin e tregtisë së një specieje të caktuar;

ë) paraqitja e kopjeve të certifikatave të peshkimit, që shoqërojnë deklaratat e përpunimit të referuara në shtojcën VI të këtij vendimi, për shembull, kur zëniet janë ndarë gjatë prodhimit;

f) dështimi për të transmetuar në kohën e duhur njoftimin paraprak të kërkuar nga neni 5 i këtij vendimi ose transmetimi i informacionit jo i plotë;

g) mospërputhjet ndërmjet të dhënave të zënieve të deklaruara nga operatori dhe informacioneve të tjera, që disponon autoriteti kompetent;

gj) anije peshkimi ose pronar i anijes, që dyshohet se ka marrë pjesë ose ka marrë pjesë në aktivitetet e PPP-së;

h) anije peshkimi, e cila ka ndryshuar së fundmi emrin, flamurin ose numrin e regjistrimit;

i) mosnjoftimi i shtetit flamur, në përputhje me nenin 22 të këtij vendimi, ose ekzistenca e informacionit për parregullsitë e mundshme në vërtetimin e certifikatave të peshkimit nga një shtet specifik flamur (p.sh. vula e vërtetimit e humbur, e vjedhur ose e falsifikuar e autoritetit kompetent);

j) mangësitë e pretenduara në sistemin e kontrollit të një shteti flamur;

k) operatorët e përfshirë më parë në aktivitete të paligjshme, që përfaqësojnë një rrezik të mundshëm në lidhje me peshkimin PPP.

Neni 20

Refuzimi i importit

1. Institucioni përgjegjës për inspektimin dhe kontrollin e ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, sipas rastit, refuzon importin e produkteve të peshkimit në Shqipëri pa pasur nevojë të kërkojë prova shtesë ose të paraqesë një kërkesë për ndihmë shtetit flamur, nëse:

a) importuesi nuk ka qenë në gjendje të paraqesë një certifikatë zënije për produktet në fjalë apo plotësimin e detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 17, të këtij vendimi;

b) produktet, të cilat importohen, nuk janë të njëjta me ato të përmendura në certifikatën e zënieve;

c) certifikata e zënieve nuk ka marrë vlefshmërinë nga autoriteti kompetent i shtetit flamur, sipas pikës 2, të nenit 11, të këtij vendimi;

ç) certifikata e zënieve nuk i përmban të gjitha informacionet e kërkuara;

d) importuesi nuk është në gjendje të provojë se produktet e peshkimit janë në përputhje me kërkesat e pikave 1 deri 3, të nenit 15, të këtij vendimi;

dh) një anije peshkimi, që përcaktohet në certifikatën e zënieve si anije e origjinës së zënieve, është e përfshirë në listën e Bashkimit Evropian dhe në atë shqiptare të anijeve PPP;

e) certifikata e zënieve e ka marrë vlefshmërinë nga autoritetet e një shteti flamur, të njohur si një shtet jobashkëpunues.

2. Institucioni përgjegjës për kontrollin e ushqimeve në pikën e inspektimit kufitar refuzon importin në Shqipëri të produkteve të peshkimit, në rastet kur ministria, pasi ka kërkuar ndihmë, në përputhje me pikën 6, të nenit 18, të këtij vendimi:

a) ka marrë një përgjigje, sipas së cilës eksportuesi nuk kishte autoritetin për të kërkuar marrjen e vlefshmërisë për certifikatën e zënies;

b) ka marrë një përgjigje, sipas së cilës produktet nuk janë në përputhje me masat konservuese dhe menaxhuese apo në rast se kushte të tjera, që janë paraqitur në këtë kre nuk janë plotësuar;

c) nuk ka marrë një përgjigje brenda datës së caktuar;

ç) ka marrë një përgjigje, e cila nuk jep shpjegime të sakta, në lidhje me pyetjet që janë paraqitur në kërkesë.

3. Në rastet kur importimi i produkteve të peshkimit refuzohet sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, produktet peshkore konfiskohen e shkatërrohen, asgjësohen apo shiten nga inspektorati përgjegjës për kontrollin e ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Të ardhurat nga shitja përdoren për bamirësi.

4. Cilido ka të drejtën e ankimit kundër vendimeve të marra, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, që kanë lidhje me të. E drejta e ankimit ushtrohet duke u bazuar në dispozitat e ligjit për inspektimin në fuqi, në Republikën e Shqipërisë.

5. Autoritetet kompetente, sipas nenit 15 të këtij vendimi, njoftojnë njëra-tjetrën dhe, sipas rastit, edhe vendin e tretë, të ndryshëm nga shteti i flamurit të përmendur në nenin 15 të këtij vendimi, për refuzimet e importimit.



Neni 21

Tranziti dhe transporti

1. Nëse, në pikën e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, produktet e peshkimit janë nën një regjim tranziti dhe transportohen në një shtet tjetër, zbatohen dispozitat e neneve 18 dhe 20 të këtij vendimi.

2. Nëse, në pikën e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, produktet e peshkut janë nën një regjim tranziti dhe transportohen në një pikë tjetër doganore në Shqipëri, ku do të vendosen nën një regjim tjetër doganor, dispozitat e neneve 17, 18 dhe 20 të këtij vendimi zbatohen në pikën e hyrjes ose në vendin e destinacionit.

3. Nëse, në pikën e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, produktet e peshkimit transbordohen dhe transportohen nga deti për në një shtet tjetër, do të zbatohen dispozitat e neneve 18 dhe 20 të këtij vendimi.

4. Ministria i komunikon në rrugë elektronike shtetit të destinacionit, sapo të njihet me informacionin dhe, në çdo rast, përpara datës së pritshme të mbërritjes në portin e destinacionit, informacionin që përmban dokumentacioni i transportit, në lidhje me llojin e produkteve të peshkimit, peshën e tyre, portin e ngarkimit dhe dërguesin e vendit të tretë, emrin e mjetit lundrues, që kryen transportin dhe portet e transbordit e të destinacionit.

Neni 22

Njoftimi i certifikatave të zënieve dhe bashkëpunimi

1. Me qëllim pranimin e certifikatave shqiptare të zënies nga Bashkimi Evropian, ministria dërgon në Komisionin Evropian njoftim, në të cilin vërteton që:

a) ka një sistem kombëtar, që garanton zbatimin, kontrollin dhe forcimin e ligjit, të rregulloreve dhe të masave menaxhuese, që duhet të zbatojnë anijet shqiptare të peshkimit;

b) inspektorati përgjegjës për peshkimin është në gjendje të certifikojë vërtetësinë e informacionit të certifikatave të zënieve dhe që ministria është në gjendje të verifikojë këto certifikata, në rast kërkesë nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Në këtë njoftim përcaktohen, gjithashtu, autoritetet e ngarkuara për këtë qëllim.

2. Informacioni për Komisionin Evropian dërgohet në përputhje me kërkesat e shtojcës VII bashkëlidhur këtij vendimi. Informacioni quhet i plotë pas marrjes nga Komisioni Evropian të njoftimit të dërguar, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Në rast se konstatohet nga Komisioni Evropian mungesa e elementeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ministria dërgon një njoftim të ri.

4. Shqipëria bashkëpunon me Komisionin Evropian, me qëllim zbatimin e skemës së certifikimit të zënieve, duke përfshirë edhe mjetet elektronike për plotësimin, certifikimin dhe paraqitjen e certifikatave të zënies, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të nenit 15, të këtij vendimi.

Ky bashkëpunim ka për qëllim që:

a) të garantojë që prodhimet e peshkimit të eksportuara nga Republika e Shqipërisë në Bashkimin Evropian të kryhen duke respektuar ligjet, rregulloret dhe masat mbrojtëse e menaxhuese në fuqi;

b) të lehtësojë autoritetet shqiptare në kryerjen e detyrave, në lidhje me formalitetet e hyrjes në porte të anijeve të peshkimit, të importit të prodhimeve peshkore dhe të detyrimit të verifikimit të certifikatave të zënieve, të parashikuara në këtë vendim;

c) të kontrollojë në vend nga ana e Komisionit Evropian ose e autoriteteve të kontrollit të përcaktuara nga Komisioni Evropian, me qëllim verifikimin dhe zbatimin efektiv të këtij bashkëpunimi;

ç) të sigurojë krijimin e një kuadri bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit ndërmjet palëve, në mbështetje të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit.

5. Bashkëpunimi i përmendur në pikën 4 të këtij neni nuk përbën një parakusht për zbatimin e këtij kreu për importet nga zëniet e kryera nga anijet e peshkimit, që mbajnë flamurin e ndonjë shteti tjetër.

6. Shqipëria pranon certifikatat e zënies së një vendi të Bashkimit Evropian ose të ndryshëm nga Bashkimi Evropian, të cilat kanë dhënë njoftim në Komisionin Evropian, në përputhje me kërkesat e pikës 3, të nenit 11, të këtij vendimi.



Neni 23 Rieksporti

1. Rieksporti i produkteve të importuara, sipas një certifikate zënieje në përputhje me këtë kre, lejohet pas dhënies së vlefshmërisë të pjesës “rieksport” të certifikatës së zënies nga inspektorati përgjegjës për peshkimin përkatës ose të një kopjeje zyrtare të saj, kur produktet e peshkut, që do të rieksportohen, përfaqësojnë një pjesë të produkteve të importuara.

2. Procedurat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 17, të këtij vendimi, zbatohen me ndryshimet përkatëse, kur produktet e peshkut rieksportohen nga një operator ekonomik i autorizuar.

3. Ministria njofton Komisionin Evropian në format elektronik, që inspektorati përgjegjës për peshkimin është autoriteti kompetent për vlefshmërinë dhe verifikimin e seksionit “rieksport” i certifikatave të zënies, në përputhje me pikën 2, të nenit 16, të këtij vendimi.

Neni 24 Regjistrimi dhe shpërndarja e informacionit

1. Ministria mban një regjistër të vendeve dhe të autoriteteve të tyre kompetente, që kanë njoftuar Komisionin Evropian. Në këtë regjistër janë të regjistruara shtetet flamur, të cilat kanë dërguar njoftim, në përputhje me pikën 6, të nenit 22, të këtij vendimi.

2. Ky regjistër publikohet në faqen zyrtare të ministrisë dhe përditësohet në vazhdimësi brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit përkatës.

3. Ministria njofton në rrugë elektronike inspektoratin përgjegjës për peshkimin për vërtetimin dhe verifikimin e certifikatave të peshkimit, të dhënat e autoriteteve të shteteve flamur, përgjegjës për vërtetimin dhe verifikimin e këtyre certifikatave.

4. Ministria ruan certifikatat origjinale të zënieve në format elektronik, të paraqitura gjatë importimit të prodhimeve peshkore, të certifikatave të eksportit e të certifikatave të rieksportit për një periudhë trivjeçare.

5. Operatorët ekonomikë të autorizuar mbajnë dokumentet origjinale të përmendura në pikën 4 të këtij neni, për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh.

KREU IV SISTEMI I ALARMIT

Neni 25 Njoftimi i alarmit

Nëse, nga informacionet e mbledhura, Komisioni Evropian publikon një njoftim alarmi të ardhur nga dyshime të bazuara për përputhshmërinë e anijeve ose të prodhimeve peshkore të disa shteteve me legjislacionin, përfshirë këtu edhe legjislacionin e zbatueshëm të njoftuar që zbatohet nga këto shtete dhe rregulloret ndërkombëtare të menaxhimit e të mbrojtjes së burimeve peshkore, ministria publikon, në faqen e saj zyrtare të internetit, një njoftim alarmi, duke njoftuar operatorët shqiptarë për këtë alarm dhe duke marrë masat e nevojshme në drejtim të shteteve në fjalë, sipas përcaktimeve në këtë kre.

Neni 26 Ndërhyrjet pas njoftimit të alarmit

1. Në rastin e alarmit, sipas nenit 25 të këtij vendimi, ministria, bazuar në menaxhimin e rrezikut:

a) identifikon dërgesat e produkteve të peshkimit të importuara, për të cilat është vendosur alarmi, si dhe kryen verifikimin e certifikatave të zënieve, si dhe të dokumentacionit të përcaktuar në nenin 15 të këtij vendimi, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 18 të këtij vendimi;

b) merr masat e nevojshme për të siguruar që, në të ardhmen, dërgesat e prodhimeve peshkore të importuara të përfshira nga ky alarm, t'i nënshtrohen verifikimit të certifikatave të zënieve dhe, nëse është e nevojshme, të dokumentacionit të kërkuar nga pikat 2 dhe 5, të nenit 15, të këtij vendimi, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 18 të këtij vendimi;

c) identifikon dërgesat e mëparshme të prodhimeve peshkore, të përfshira nga ky alarm, dhe kryen verifikimet e nevojshme, përfshirë verifikimin e certifikatave të zënieve të paraqitura më parë;

ç) kontrollon anijet e peshkimit, që përfshihen nga ky alarm, duke kryer verifikime, hetime ose inspektime në det, ose në vendet e tjera të zbarkimit, në zbatim të legjislacionit kombëtar e ndërkombëtar.

2. Ministria u komunikon shteteve të huaja në fjalë, sa më shpejt të jetë e mundur, konkluzionet e



verifikimeve të kryera dhe kërkesat për verifikim dhe veprimet e ndërmarra, kur është konstatuar mospërputhje me ligjet, rregulloret ose masat ndërkombëtare të ruajtjes e të menaxhimit.

3. Në rast se, në bazë të verifikimeve sipas pikës 1 të këtij neni, rezulton se dyshimet nuk qëndrojnë më, ministria merr menjëherë masa:

a) duke publikuar në faqen e saj zyrtare të internetit njoftimin, që anulon njoftimin e alarmit të mëparshëm;

b) për të informuar shtetin flamur;

4. Në rast se, në bazë të verifikimeve të kryera sipas pikës 1 të këtij neni, rezulton se dyshimet qëndrojnë, ministria merr menjëherë masa:

a) duke publikuar në faqen e saj zyrtare të internetit njoftimin që përditëson njoftimin e alarmit të mëparshëm;

b) për të informuar shtetin flamur;

c) duke paraqitur, në rast se është e nevojshme, këtë fakt në Organizatën Rajonale të Menaxhimit të Peshkimit, masat menaxhuese dhe mbrojtëse të së cilës mund të jenë shkelur.

5. Në rast se, në bazë të verifikimeve sipas pikës 1 të këtij neni, rezulton se janë shkelur ligjet dhe rregullat ndërkombëtare, ministria merr menjëherë masa:

a) duke publikuar në faqen e saj zyrtare të internetit njoftimin, që përditëson njoftimin e alarmit të mëparshëm;

b) për të informuar shtetin flamur;

c) duke paraqitur, në rast se është e nevojshme, këtë fakt në Organizatën Rajonale të Menaxhimit të Peshkimit, masat menaxhuese dhe mbrojtëse të së cilës mund të jenë shkelur.

KREU V IDENTIFIKIMI I ANIJEVE TË PESHKIMIT TË PËRFSHIRA NË PESHKIMIN PPP

Neni 27

Peshkimi i dyshuar PPP

1. Ministria grumbullon dhe përpunon të gjithë informacionin për peshkimin PPP, sipas kërkesave të këtij vendimi, si dhe informacione të tjera, si:

a) të dhënat nga zëniet;

b) informacione në lidhje me shkëmbimet tregtare nga doganat ose INSTAT-i;

c) regjistrat ose bazën e të dhënave për anijet;

ç) programet e dokumentimit të zënieve ose të dhënat statistikore të organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit;

d) raportet për pikasjet ose aktivitete të tjera të anijeve të peshkimit, të dyshuara për aktivitet PPP ose të listave të anijeve të dërguara, ose të miratuara nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit;

dh) raporte sipas vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar;

e) çfarëdolloj informacioni tjetër të rëndësishëm të ardhur nga portet ose zonat e peshkimit.

2. Inspektorati përgjegjës për peshkimin, në çdo kohë, i paraqet ministrisë çdo informacion shtesë të rëndësishëm për krijimin e listës së anijeve PPP. Drejtoria përgjegjëse për peshkimin në ministri qarkullon informacionin në format elektronik, së bashku me të gjitha provat e ofruara, të shtetet e huaja dhe të shtetet e flamurit në fjalë, duke vendosur në dijeni ministrinë.

3. Ministria mban një dosje të veçantë për çdo anije peshkimi të dyshuar në peshkimin PPP dhe e përditëson atë sa herë ka informacione të reja.

Neni 28

Peshkimi i prezumuar PPP

1. Në bazë të informacioneve të përcaktuara në nenin 27 të këtij vendimi, ministria identifikon anijet e peshkimit, për të cilat prezumohet që të jenë të përfshira në peshkimin PPP dhe që justifikon fillimin e një hetimi në bashkëpunim me shtetin, flamurin e të cilit mban anija e peshkimit.

2. Ministria u dërgon shteteve, flamurin e të cilave mbajnë anijet e peshkimit, që janë identifikuar si të përfshira në peshkimin PPP, një kërkesë zyrtare për hetim, ku kërkon:

a) të gjitha informacionet e grumbulluara për përfshirjen e anijes në fjalë në peshkimin PPP;

b) fillimin e hetimit mbi rastin dhe për t'i komunikuar menjëherë ministrisë rezultatet e arritura;

c) marrjen e masave të menjëhershme zbatuese, në rast se dyshimet e shprehura ndaj anijes së peshkimit janë të bazuara, dhe t'i komunikojë ministrisë;

ç) informimin e pronarëve ose të operatorëve të anijeve të peshkimit në fjalë për arsyet e hollësishme,



që justifikojnë përfshirjen e parashikuar në listë, dhe për pasojat që do të rezultonin nga përfshirja e mundshme e anijes së peshkimit në listën e anijeve PPP, siç parashikohet në nenin 39 të këtij vendimi. Gjithashtu, shtetit flamur i kërkohet t'i transmetojnë ministrisë të dhëna në lidhje me pronarët dhe, sipas rastit, operatorët e anijes së peshkimit, në mënyrë që këta persona të mund të dëgjohen, në përputhje me pikën 2, të nenit 29, të këtij vendimi.

3. Ministria njofton shtetin, flamurin e të cilit mban anija, sipas rregullave të parashikuara në krerët VI dhe VII.

Neni 29

Hartimi i listës së anijeve PPP

1. Ministria krijon listën e anijeve të peshkimit PPP. Në këtë listë përfshihen anijet, për të cilat informacioni i marrë sipas këtij vendimi, si dhe pas veprimeve të kryera sipas neneve 27 dhe 28 të këtij vendimi, vlerësohen për pjesëmarrjen në peshkimin PPP të këtyre anijeve dhe shtetet e flamurit të të cilave nuk kanë përmbushur detyrimin e shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 2, të nenit 28, të këtij vendimi, për të luftuar një peshkim PPP.

2. Përpara regjistrimit të një anijeje në listën PPP, ministria i dërgon pronarit ose përdoruesit të anijes në fjalë një relacion për arsyet, për të cilat anija do të regjistrohet në këtë listë, duke përshkruar të gjitha elementet, që çojnë në dyshimin se kjo anije është e përfshirë në peshkim PPP. Ky relacion shpjegon arsyet dhe të drejtën e kërkesës ose të dërgimit të informacioneve të tjera shtesë, si dhe i jep mundësinë pronarit ose përdoruesit që të dëgjohet e të ushtrojë të drejtën e ankimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

3. Në rastin kur ministria vendos të regjistrojë anijen në listën PPP, ky vendim i dërgohet pronarit ose përdoruesit të anijes së peshkimit së bashku me arsyet.

4. Detyrimet e ministrisë për zbatimin e pikave 2 dhe 3 të këtij neni zbatohen pa cenuar përgjegjësinë kryesore të shtetit flamur kundrejt anijes së peshkimit dhe zbatohen vetëm në rast se ministria identifikon qartësisht pronarin ose përdoruesin e anijes së peshkimit.

5. Ministria, gjithashtu, njofton shtetin flamur për vendimin e saj për të përfshirë në listën e anijeve

PPP të anijes së peshkimit së bashku me arsyen përkatëse.

6. Ministria u kërkon vendeve flamur, që kanë anije të regjistruara në listën PPP, që:

a) të njoftojnë pronarët e anijeve për regjistrimin e anijeve të tyre në listën PPP, për arsyet që justifikojnë këtë regjistrim, si dhe për pasojat;

b) të marrin të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar peshkimin PPP, përfshirë këtu, nëse është e nevojshme, çregjistrimin, anulimin e lejes së anijeve në fjalë, si dhe të njoftojnë edhe ministrinë për masat e marra.

Neni 30

Heqja nga lista e anijeve PPP

1. Ministria heq nga lista PPP anijet e peshkimit, për të cilat shteti flamur vërteton që:

a) nuk kanë kryer peshkimin PPP, që ka çuar në regjistrimin e tyre në listë;

b) ka marrë masat e nevojshme dhe ka vendosur dënimet proporcionale, shkurajuese dhe efektive për të luftuar peshkimin PPP.

2. Pronari ose përdoruesi i një anijeje peshkimi të regjistruar në listën PPP paraqet kërkesë për rishikimin e statusit të anijes së peshkimit, në rast se shteti flamur nuk vepron sipas pikës 1 të këtij neni. Ministria vlerëson mundësinë e heqjes nga lista të anijes, vetëm në rast se:

a) pronari ose përdoruesi paraqet prova se nuk kryen më peshkim PPP;

b) anija e peshkimit është mbytur ose është dërguar për demolim.

3. Në të gjitha rastet e tjera, ministria vlerëson mundësinë për të hequr anijen e peshkimit nga lista PPP, vetëm në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) kanë kaluar së paku 2 (dy) vjet nga regjistrimi dhe ministria nuk ka marrë njoftime për peshkimin PPP për anijen në fjalë, sikurse parashikohet në nenin 27 të këtij vendimi;

b) pronari jep informacione për aktivitetin aktual të anijes, të cilat vërtetojnë se kjo anije kryen aktivitet, në përputhje me të gjitha rregullat dhe masat menaxhuese në fuqi;

c) anija në fjalë ose pronari i saj apo përdoruesi i saj nuk kanë aktivitet peshkimi ose financiar, të drejtpërdrejtë ose jo, me ndonjë anije, për të cilën dyshohet ose konfirmohet që merr pjesë në peshkim PPP.



Neni 31

Përmbajtja, publikimi dhe përditësimi i listës së anijeve PPP

1. Regjistri i anijeve PPP, për secilën anije, përmban:

- a) emrin dhe eventualisht emrat e mëparshëm;
- b) të dhëna për flamurin dhe eventualisht flamurët e mëparshëm;
- c) të dhëna për pronarin dhe/ose, nëse duhet, pronarët e mëparshëm, duke përfshirë pronarët e vërtetë;
- ç) të dhëna për përdoruesin dhe, nëse është e nevojshme, përdoruesit e mëparshëm;
- d) emrin e thirrjes dhe eventualisht sinjalin e thirrjes aktuale ose të mëparshme;
- dh) numrin IMO (nëse ka);
- e) fotografi, nëse ka;
- ë) datën e regjistrimit të parë të anijes;
- f) përshkrimin e aktiviteteve, që justifikojnë regjistrimin e anijes në regjistër, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton këtë aktivitet.

2. Ministria publikon listën e anijeve PPP në faqen zyrtare të saj të internetit, duke e përditësuar informacionin jo më vonë se çdo 3 (tre) muaj. Kjo listë u njoftohet organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit, FAO-s, për të parandaluar, reduktuar e ndaluar peshkimin PPP, si dhe për anëtarë të shoqërisë civile që bëjnë kërkesë.

Neni 32

Listat e anijeve PPP të miratuara nga organizatat rajonale të peshkimit

1. Përveç anijeve të parashikuara në pikën 1, të nenit 29, të këtij vendimi, në listën kombëtare të anijeve PPP regjistrohen anijet e përcaktuara në listat e organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit dhe të Komisionit Evropian. Fshirja nga kjo listë rregullohet nga vendimet e këtyre organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit dhe të Komisionit Evropian.

2. Ministria, çdo vit, njofton inspektoratin përgjegjës për peshkimin me *email* ose shkresë zyrtare për listat e anijeve të peshkimit, që dyshohet ose konfirmohet se janë të përfshira në peshkimin PPP të dërguara nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit.

3. Ministria njofton menjëherë inspektoratin përgjegjës për peshkimin për çdo shtesë, çdo fshirje nga lista ose çdo modifikim të listave të përmendura në pikën 2 të këtij neni, në çdo kohë që ndodhin këto ndryshime. Neni 39 i këtij vendimi zbatohet në lidhje me anijet që publikohen në listat e anijeve të organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit PPP, sa herë ndryshohen listat që nga momenti i njoftimit të tyre tek inspektorati përgjegjës për peshkimin.

KREU VI

VENDET JOBASHKËPUNUESE

Neni 33

Identifikimi i vendeve jobashkëpunuese

1. Identifikimi i vendeve jobashkëpunuese bazohet në vlerësimin e të gjithë informacionit të mbledhur sipas krerëve II, III, IV, V, VIII, X dhe XI të këtij vendimi ose çfarëdolloj informacioni tjetër të rëndësishëm, si të dhënat për zëniet, informacionet për shkëmbimet tregtare kombëtare dhe nga burime të tjera të besueshme, regjistra dhe banka të dhënash të anijeve, programe të dokumentimit të zënieve dhe të listës së anijeve PPP të organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit dhe të çfarëdolloj informacioni që vjen nga portet dhe zonat e peshkimit.

2. Vendet jobashkëpunuese klasifikohen ato vende, që nuk plotësojnë detyrimet e së drejtës ndërkombëtare, si shtete flamur, shtete bregdetare ose tregtare dhe që nuk kanë marrë masat e nevojshme me qëllim parandalimin, reduktimin dhe ndalimin e peshkimit PPP.

3. Vlerësimi bazohet mbi masat e marra nga vendet e tjera, në lidhje me:

- a) peshkimin PPP të dokumentuar, të kryer nga anijet e peshkimit me flamurin e tyre, nga qytetarët e tyre ose nga anijet e peshkimit, që zhvillojnë aktivitet në ujërat e tyre ose që përdorin portet e tyre;
- b) pranimin në tregjet e tyre të prodhimeve, që vijnë nga peshkimi PPP.

4. Për qëllimet e pikës 2 të këtij neni, ministria merr parasysh:

- a) nëse vendi i huaj në fjalë bashkëpunon në mënyrë efektive, duke dhënë një përgjigje ndaj kërkesave të bëra nga ministria për të hetuar, për të dhënë komente ose për të ndjekur aktivitetet e peshkimit PPP dhe aktivitetet e lidhura me to;



b) nëse vendi i huaj në fjalë ka marrë masa zbatuese efektive, në lidhje me operatorët përgjegjës për peshkimin PPP dhe, në veçanti, nëse janë zbatuar sanksione me ashpërsi të mjaftueshme për t'i privuar shkelësit nga përfitimet që rrjedhin nga peshkimi PPP;

c) historia, natyra, rrethanat, shtrirja dhe aktivitetet e peshkimit PPP të dyshuara;

ç) për vendet në zhvillim, kapacitetin ekzistues të kontrollit të autoriteteve të tyre kompetente.

5. Ministria merr në konsideratë edhe elementet e mëposhtme:

a) Ratifikimin/aderimin e legjislacionit ndërkombëtar në fushën e peshkimit dhe, në mënyrë të veçantë të marrëveshjeve për zbatimin e Konventës mbi të Drejtën e Detit, ratifikuar me ligjin nr. 9055, datë 24.4.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën mbi të Drejtën e Detit’ të OKB-së”, marrëveshjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për popullatat peshkore dhe marrëveshjen për të nxitur respektimin e masave ndërkombëtare të ruajtjes e të menaxhimit nga anijet e peshkimit në det të hapur në kuadër të Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) të OKB-së;

b) Të qenët palë në organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit ose të zotimit për të zbatuar masat mbrojtëse e menaxhuese të miratuara prej tyre;

c) Çfarëdolloj veprimi ose mospërmbyshjeje që ky vend mund të ketë kryer e që sjell pasoja në efikasitetin e ligjeve, rregulloreve dhe masave ndërkombëtare të mbrojtjes dhe të menaxhimit.

Neni 34

Praktika e zbatueshme për vendet e identifikuar si vende jobashkëpunuese

1. Ministria u dërgon menjëherë vendeve jobashkëpunuese një njoftim për mundësinë e identifikimit si vende jobashkëpunuese, në bazë të kritereve të nenit 33 të këtij vendimi. Në njoftim përfshihet informacioni i mëposhtëm:

a) arsyeja e identifikimit së bashku me të gjitha elementet provuese;

b) mundësia e përgjigjes me shkrim, në lidhje me vendimin e identifikimit si vend jobashkëpunues dhe e dërgimit të informacionit të nevojshëm, si prova që mund kundërshtojnë identifikimin ose,

nëse është rasti, një plan veprimi për të përmirësuar situatën, si dhe masat korrektuese të marra;

c) e drejta për të kërkuar informacione shtesë;

ç) pasojat që rrjedhin nga identifikimi si vend jobashkëpunues të parashikuara në nenin 40 të këtij vendimi.

2. Në njoftimin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ministria përfshin një kërkesë që vendi i huaj në fjalë të marrë çdo masë të nevojshme për ndërprerjen e aktiviteteve të peshkimit PPP në fjalë dhe parandalimin e çdo aktiviteti të tillë në të ardhmen, si dhe të korrigjojë çdo veprim ose mosveprim të referuar në shkronjën “c”, të pikës 5, të nenit 33, të këtij vendimi.

3. Ministria i transmeton njoftimin dhe kërkesën e tij vendit të huaj në fjalë. Ministria kërkon të marrë konfirmimin nga ai vend që ka marrë njoftimin.

4. Në njoftimin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ministria përcakton afatin maksimal prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh për të marrë një përgjigje nga vendi tjetër.

Neni 35

Krijimi i një liste të vendeve jobashkëpunuese

1. Ministria njofton menjëherë vendin në fjalë për vendimin e saj, për identifikimin si vend jobashkëpunues dhe penalitetet që zbatohen sipas nenit 40 të këtij vendimi, si dhe i bën ftesë që të përmirësojë situatën dhe të garantojë respektimin e masave mbrojtëse e menaxhuese nga anijet e tij.

2. Ministria krijon, mban e përditëson listën e vendeve jobashkëpunuese dhe njeh listën e vendeve jobashkëpunuese të Bashkimit Evropian, si dhe çdo vendim të Komisionit Evropian për identifikimin e vendeve të treta si vende jobashkëpunuese, duke zbatuar të gjitha penalitetet e përcaktuara në nenin 40 të këtij vendimi.

Neni 36

Heqja nga lista e vendeve jobashkëpunuese

1. Ministria heq nga lista e vendeve jobashkëpunuese vendin, që demonstroi se ka përmirësuar situatën, e cila ishte shkak për regjistrimin e tij si vend jobashkëpunues. Vendimi për heqjen nga lista merret edhe në rastet kur vendi në fjalë demonstroi, nëpërmjet dokumentacionit dhe të dhënave të verifikueshme, se ka marrë masa



konkrete që sigurojnë një përmirësim afatgjatë të situatës.

2. Ministria njih dhe zbaton çdo vendim të Komisionit Evropian për heqjen nga lista e vendeve të treta si vende jobashkëpunuese dhe zbaton të gjitha detyrimet e përcaktuara në nenin 40 të këtij vendimi.

Neni 37

Publikimi i listës së vendeve jobashkëpunuese

Ministria publikon listën e vendeve jobashkëpunuese në faqen e saj zyrtare të internetit, duke e përditësuar informacionin çdo 3 (tre) muaj. Kjo listë u njoftohet organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit FAO-s, për të parandaluar, reduktuar e ndaluar peshkimin PPP, si dhe anëtarëve të shoqërisë civile që bëjnë kërkesë.

Neni 38

Masat e emergjencës

1. Nëse ka prova që masat e miratuara nga një vend i huaj dëmtojnë masat e ruajtjes dhe menaxhimit të miratuara nga një organizatë rajonale e menaxhimit të peshkimit, ministria ka të drejtë të miratojë, në përputhje me detyrimet e saj ndërkombëtare, masa emergjente, që nuk zgjasin më shumë se 6 (gjashtë) muaj. Nëse rrethanat mbeten të pandryshuara dhe ekzistojnë ende prova të mjaftueshme për cenimin e masave ndërkombëtare, afati mund të zgjatet me një vendim të dytë për një periudhë shtesë jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj të tjerë.

2. Masat emergjente të përmendura në pikën 1 të këtij neni përfshijnë, ndër të tjera:

a) ndalimin e hyrjes në portet shqiptare për anijet e peshkimit me flamur të vendit të huaj, me përjashtim të rasteve të forcës madhore, siç përcaktohet në pikën 2, të nenit 3, të këtij vendimi, për shërbimet rreptësisht të nevojshme për të korrigjuar ato situata;

b) ndalimin operacioneve të përbashkëta të peshkimit ndërmjet anijeve shqiptare dhe atyre me flamur të vendeve të huaja;

c) ndalimin e peshkimit nga anijet me flamur shqiptar në ujërat nën juridiksionin e vendit të huaj, përveç rasteve të përcaktuara me marrëveshje dypalëshe të peshkimit;

ç) ndalimin e importit të peshkut të gjallë për kultivim nga ujërat e vendit të huaj në fjalë;

d) ndalimin e përdorimit të peshkut të gjallë të zënë nga anije me flamur të vendit të huaj për kultivim në ujërat detare nën juridiksionin e territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Masat emergjente kanë efekt të menjëhershëm dhe u njoftohen vendeve të huaja në fjalë dhe organizatave rajonale, ku bën pjesë Shqipëria, në format elektronik/të printuar.

KREU VII

MASAT E ZBATUESHME PËR ANIJET E PESHKIMIT DHE SHITETET PJESËMARRËSE NË PESHKIM PPP

Neni 39

Masat e zbatueshme për anijet e peshkimit të përfshira në listën e anijeve PPP

1. Ndaj anijeve të peshkimit, që bëjnë pjesë në listën PPP, zbatohen masat e mëposhtme:

a) ndalohen të gjitha format e asistencës, përfshirë përpunimin, transbordimin dhe aktivitetet e përbashkëta të peshkimit me anije të përfshira në listën PPP;

b) nuk lëshohet asnjë autorizim sipas nenit 69, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, në lidhje me anijet e peshkimit PPP;

c) revokohen të gjitha autorizimet në fuqi të peshkimit ose lejet e veçanta të peshkimit të lëshuara nga ministria, sipas nenit 69, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, në lidhje me anijet e përfshira në peshkimin PPP;

ç) ndalohet dhënia me qira ose marrja në operim e anijeve të përfshira në listën PPP, që mbajnë flamurin e një shteti të huaj;

d) me përjashtim të rasteve të forcës madhore ose në rast vështirësie, anijet e peshkimit PPP nuk përdorin portet shqiptare të peshkimit. Hyrja në këto porte lejohet vetëm me kushtin që të konfiskohen zëniet në bord dhe, nëse është rasti, edhe mjetet e ndaluara të peshkimit, në përputhje me masat menaxhuese dhe mbrojtëse të miratuara nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit dhe legjislacionin për peshkimin në fuqi. Zëniet dhe mjetet e ndaluara të peshkimit në bordin e anijeve të peshkimit PPP sekuestrohen edhe në rastet kur anijet përdorin portet shqiptare për arsye të forcës madhore ose në rast vështirësie;



dh) me përjashtim të rasteve të forcës madhore ose në rast vështirësie, anijet e peshkimit PPP nuk furnizohen në portet shqiptare ose t'u ofrohen shërbime;

e) me përjashtim të rasteve të forcës madhore ose në rast vështirësie, anijet e peshkimit PPP nuk ndryshojnë ekuipazh në portet shqiptare;

ë) anijet e peshkimit të listuar si PPP nuk regjistrohen e nuk pajisen me leje peshkimi në Shqipëri. Në asnjë rast nuk lejohet regjistrimi në regjistrin shqiptar të anijeve të përfshira në listën PPP;

f) ndalohet importi i produkteve të peshkimit të zëna nga anijet PPP. Certifikatat e zënieve, që shoqërojnë këto produkte, nuk pranohen ose të marrin vlefshmëri;

g) ndalohet eksporti ose rieksperti për qëllime përpunimi të produkteve të peshkimit, që vijnë nga anijet PPP;

gj) anijet e peshkimit PPP, pa ekuipazh, pranohen në portet shqiptare vetëm kur janë të destinuara për qëllim demolimi, por edhe në këtë rast kur nuk kanë procese gjyqësore ose gjoba ndaj këtyre anijeve ose personave fizikë e juridikë, përfaqësues të saj.

Neni 40

Masat e zbatueshme për vendet jobashkëpunuese

1. Ndaj vendeve jobashkëpunuese, që bëjnë pjesë në listën PPP, zbatohen masat e mëposhtme:

a) ndalohet importi në Republikën e Shqipërisë i produkteve të peshkimit të anijeve që mbajnë flamurin e tyre. Certifikatat e zënieve, që shoqërojnë këto produkte, nuk pranohen ose nuk marrin vlefshmëri. Në rast se një vend është identifikuar si jobashkëpunues vetëm për peshkim PPP në një popullatë të veçantë peshqish, ndalimi i importit zbatohet vetëm për produktet që rrjedhin nga ajo popullatë;

b) u ndalohet operatorëve shqiptarë të blejnë anije peshkimi me flamur të këtij vendi;

c) u ndalohet anijeve me flamur shqiptar të shiten në këtë vend;

ç) anijeve shqiptare të peshkimit u ndalohet të nënshkruajnë marrëveshje me këto vende;

d) ndalohet ndryshimi i flamurit të anijeve shqiptare të peshkimit në këto vende;

dh) ndalohet të nënshkruhen marrëveshje tregtare ndërmjet subjekteve shqiptare dhe atyre të këtij vendi;

e) ndalohen aktivitetet e përbashkëta të peshkimit ndërmjet anijeve shqiptare dhe anijeve që mbajnë flamurin e atij vendi;

ë) ministria kërkon prishjen e marrëveshjeve tregtare në sektorin e peshkimit të bëra me vendet në fjalë me arsyen e moszbatimit të detyrimeve të marra për luftën ndaj peshkimit PPP;

f) ministria nuk hyn në negociata për lidhjen e marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit, përfshirë marrëveshjet dypalëshe ose partneritetit për peshkim, me këto vende për aq kohë sa ato qëndrojnë në listën e vendeve jobashkëpunuese;

g) ndalohet pronësia, duke përfshirë pronarët përfitues, operimi ose menaxhimi nga operatorët shqiptarë të anijeve të peshkimit, që mbajnë flamurin e atyre vendeve. Pronarët e anijeve shqiptare, duke përfshirë pronarët përfitues të anijeve të peshkimit, që mbajnë flamurin e këtyre vendeve, kërkojnë që këto anije peshkimi të hiqen nga regjistri i atyre vendeve brenda 2 (dy) muajve nga publikimi i listës së vendeve të tjera jobashkëpunuese, në përputhje me nenin 37 të këtij vendimi. Kur kërkesa nuk mund të bëhet drejtpërdrejt nga pronarët e anijeve, duke përfshirë pronarët përfitues, ata udhëzojnë një person fizik ose juridik përkatës të autorizuar të veprojë në emër të tyre për të kërkuar një anulim të tillë brenda periudhës së përcaktuar;

gj) ndalohet qasja në shërbimet portuale dhe kryerja e operacioneve të zbarkimit apo transbordimit në portet shqiptare nga anijet e peshkimit, që mbajnë flamurin e këtyre vendeve.

2. Ministria informon Komisionin Evropian dhe organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit për masat e zbatuara ndaj vendeve jobashkëpunuese.

KREU VIII

SHTETASIT SHQIPTARË TË PËRFSHIRË NË AKTIVITETET TË PESHKIMIT PPP

Neni 41

Shtetasit shqiptarë që ndihmojnë ose kryejnë peshkim PPP

1. Shtetasve shqiptarë u ndalohet të ndihmojnë, të zhvillojnë peshkimin PPP, qoftë si peshkatarë të thjeshtë, ashtu edhe si pronarë ose përdorues të



anijeve të peshkimit të regjistruara në listën e anijeve PPP.

2. Pa cenuar përgjegjësinë kryesore të shtetit flamur, ministria bashkëpunon me vendet e tjera dhe merr të gjitha masat e duhura, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar, me qëllim identifikimin e shtetasve që mbështesin ose përfshihen në peshkimin PPP.

3. Pa cenuar përgjegjësinë kryesore të shtetit flamur, ministria, ndaj shtetasve të identifikuar si mbështetës ose të përfshirë në peshkimin PPP, merr veprimet e duhura, sipas legjislacionit penal në fuqi.

Neni 42

Parandalimi dhe sanksionet

1. Ministria mbledh dhe verifikon çdo informacion lidhur me çdo interes ligjor, të drejtë përfitimi ose interes financiar në lidhje me anijet e peshkimit që mbajnë flamurin e një vendi të huaj ose në lidhje me kontrollin e këtyre anijeve të peshkimit, si dhe emrat e anijeve të peshkimit në fjalë në pronësi të shtetasve shqiptarë.

2. Shtetasve shqiptarë u ndalohet t'u shesin ose t'u eksportojnë anije peshkimi operatorëve të lidhur me shfrytëzimin, menaxhimin ose pronësinë e anijeve të peshkimit të përfshira në listën e anijeve PPP.

3. Operatorët shqiptarë që janë përfshirë, drejtpërdrejt ose përmes lidhjeve të kontrollit, në menaxhimin, shfrytëzimin apo pronësinë e anijeve në listën PPP, përjashtohen nga çdo formë mbështetjeje financiare nga buxheti i shtetit ose fondet ndërkombëtare të menaxhuara nga autoritetet shqiptare.

4. Ministria siguron informacion për ekzistencën e çdo marrëveshjeje ndërmjet shtetasve shqiptarë dhe një vendi të huaj, që lejon rivendosjen e një flamuri të ri të anijeve të peshkimit, që mbajnë flamurin shqiptar, në një vend të tillë të huaj.

KREU IX

MASAT E MENJËHERSHME TË ZBATIMIT

Neni 43

Shkeljet e rënda

1. Dispozitat e këtij vendimi, që zbatohen për shkeljet e rënda, sipas përcaktimeve të nenit 117, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, përfshijnë:

a) shkelje të rënda të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në ujërat detare nën sovranitetin ose juridiksionin e Republikës së Shqipërisë;

b) shkeljet e rënda të kryera nga anije që mbajnë flamurin shqiptar ose nga shtetas shqiptarë, pavarësisht vendndodhjes së kryerjes së veprimit;

c) shkelje të rënda të konstatuara në territorin ose në ujërat e përmendura në shkronjën "a", të kësaj pike, por që janë kryer në det të hapur ose nën juridiksionin e një vendi të huaj dhe që janë sanksionuar në përputhje me pikën 4, të nenit 10, të këtij vendimi.

2. Për qëllime të këtij vendimi, shkelje të rënda nënkuptohen:

a) aktivitetet që konsiderohen se përbëjnë peshkim PPP, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 117, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar;

b) veprimtari tregtare të lidhura drejtpërdrejt me peshkimin PPP, duke përfshirë tregtinë në/ose importin e produkteve të peshkimit;

c) falsifikimi i dokumenteve të përmendura në këtë vendim ose përdorimi i dokumenteve të tilla false ose të pavlefshme.

Neni 44

Procedimi në rast të shkeljeve të rënda

1. Nëse një person dyshohet të ketë kryer ose është kapur në flagrancë duke kryer një shkelje të rëndë apo kur një subjekt dyshohet të jetë përgjegjës i një shkeljeje të rëndë, ministria fillon një hetim të thelluar dhe në varësi të shkallës së dëmit të shkaktuar. Përveç sa parashikohet në nenet 128, shkronjat "e" dhe "dh", 129 e 130, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, ministria merr masat e menjëhershme të zbatimit, si më poshtë vijon:

a) ndalimin e menjëhershëm të aktivitetit të peshkimit të anijes;

b) kthimin në port të anijes së peshkimit;

c) dërgimin e mjetit të transportit në një vend tjetër për inspektim;

ç) detyrimin e subjektit për depozitimin e një garancie financiare;

d) sekuestrimin e veglave të peshkimit, zëniet ose produkteve të peshkimit;

dh) bllokimin e përkohshëm të anijes së peshkimit ose mjetit transportues në fjalë;



e) pezullimin e autorizimit për peshkim.

2. Masat e zbatimit duhet të jenë të natyrës së tillë, që të parandalojnë vazhdimin e shkeljes serioze në fjalë dhe të lejojnë inspektoratin përgjegjës për peshkimin të përfundojë hetimin e tyre.

KREU X

ZBATIMI I DISPOZITAVE NË KUADËR TË ORGANIZATAVE RAJONALE TË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT, NË LIDHJE ME PIKASJEN E ANIJEVE TË PESHKIMIT

Neni 45

Pikasja në det

1. Dispozitat e këtij kreu zbatohen për aktivitetet e peshkimit, subjekt i pikasjes në det, të miratuara në kuadër të organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit dhe që janë detyruese për Republikën e Shqipërisë.

2. Në rast se pikasin një anije peshkimi, që është duke zhvilluar aktivitet peshkimi PPP, oficeri i shërbimit të peshkimit në QNOD dhe inspektorët e peshkimit plotësojnë menjëherë një raport vëzhgimi. Ky raport dhe hetimi i kryer nga ministria shërbejnë si elemente të provës për sistemet e identifikimit, në zbatim të këtij vendimi.

3. Në rast se një anije peshkimi me flamur shqiptar pikas një anije tjetër me flamur shqiptar ose të huaj, duke kryer aktivitet peshkimi PPP, siguron marrjen e sa më shumë informacioneve të mundshme dhe kryesisht informacione që lidhen me:

- a) emrin dhe një përshkrim të anijes së peshkimit;
- b) sinjalin e thirrjes së anijes së peshkimit;
- c) numrin e regjistrimit dhe, nëse mundet, numrin IMO/*Lloyd*;
- d) të dhëna për flamurin e anijes së peshkimit;
- d) të dhëna për koordinatat gjeografike (gjatësi, gjerësi) të anijes së peshkimit në momentin e pikasjes së parë;
- dh) datën/orën e pikasjes së parë;
- e) një ose disa foto të anijes së peshkimit, si provë e pikasjes;
- ë) çdo informacion tjetër të rëndësishëm, në lidhje me aktivitetin e paligjshëm të anijes së peshkimit në fjalë.

4. Raportet e pikasjes dërgohen menjëherë tek inspektorati përgjegjës për peshkimin dhe ministria. Ministria i dërgon raportin e pikasjes shtetit, flamurin e të cilit mban anija, ose sekretarit ekzekutiv të Organizatës Rajonale të Menaxhimit të Peshkimit, Faqe | 24762

me qëllim që të ndiqet, në përputhje me masat e miratuara nga këto organizata.

5. Në rast se ministria merr një raport pikasjeje për aktivitetin e një anijeje peshkimi me flamur shqiptar nga një shtet, që është palë kontraktuese e një organizate rajonale të menaxhimit të peshkimit, ajo ia transmeton brenda 10 (dhjetë) ditëve sekretarit ekzekutiv të organizatës rajonale përgjegjëse për menaxhimin e peshkimit, me qëllim që të ndiqet, nëse shihet e arsyeshme, në përputhje me masat e marra nga kjo organizatë.

6. Ky nen zbatohet pa cenuar dispozitat më strikte të miratuara nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit, në të cilat Shqipëria është palë kontraktuese.

7. Ministria shqyrton, gjithashtu, informacionet e dokumentuara për anijet e peshkimit, që janë objekt vëzhgimi, të dërguara nga qytetarët, nga organizatat e shoqërisë civile, përfshirë ato që veprojnë në fushën e mjedisit, si dhe nga përfaqësues të grupeve të interesit në sektorin e peshkimit apo të tregtisë së prodhimeve të peshkimit.

8. Formulari për transmetimin e informacionit në lidhje me anijet e peshkimit të pikasura, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, është sipas shtojcës VIII A të këtij vendimi dhe mënyra e plotësimit të formularit është në shtojcën VIII B të këtij vendimi.

Neni 46

Hetimet për anijet e peshkimit të pikasura

1. Inspektorati përgjegjës për peshkimin fillon menjëherë një hetim për aktivitetet e anijeve të peshkimit, që mbajnë flamurin e tyre, të cilat janë pikasur sipas pikës 5, të nenit 45, të këtij vendimi.

2. Inspektorati përgjegjës për peshkimin harton një raport për ministrinë me detajet e fillimit të hetimit dhe të çdo veprimi të ndërmarrë ose të synuar, në lidhje me anijet e peshkimit, që pikasen e që mbajnë flamurin shqiptar, brenda 2 (dy) muajve nga njoftimi i raportit të pikasjes, në përputhje me pikën 4, të nenit 45, të këtij vendimi.

KREU XI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 47

Shfuqizime

Vendimi nr. 302, datë 10.4.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e sistemit të inspektimit për



parandalimin, shkurajimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar (PPP) dhe krijimin e skemës së certifikimit të zënieve në peshkim”, shfuqizohet.

Neni 48

Institucioni që ngarkohet për zbatimin e vendimit

Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, inspektorati përgjegjës për peshkimin,

institucioni përgjegjës për shërbimet në peshkim dhe akuakulturë, institucioni përgjegjës për kontrollin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Shtojca 1

ex kapitulli 3 ex 16 04 ex 16 05	Prodhime të akuakulturës me prejardhje nga rasatet ose larvat.
0302 91 00 ex 0302 99 00 0303 91 10 0303 91 90 ex 0303 99 00 0305 20 00 0305 72 00 ex 0305 79 00 ex 16 04	Mëlçitë, vezët, material biologjik, fletë peshku, kokat, bishtat, fshikëza e ajrit dhe të tjera të brendshme të ngrënshme të peshkut, koka peshku, bishta dhe gojë (me përjashtim të pendëve të peshqve të klasës <i>Chondrichthyes</i>).
0301 11 00 0301 19 00	Peshq zbukurues, të gjallë.
ex 0301 91	Troftat (<i>Salmo trutta</i> , <i>Oncorhynchus mykiss</i> , <i>Oncorhynchus clarki</i> , <i>Oncorhynchus aguabonita</i> , <i>Oncorhynchus gilae</i> , <i>Oncorhynchus apache</i> e <i>Oncorhynchus chrysogaster</i>), të gjalla, të peshkuara në ujërat e ëmbla.
ex 0301 92	Ngjala (<i>Anguilla</i> spp.), të gjalla, të peshkuara në ujërat e ëmbla.
0301 93 00	Familja e krapit (<i>Cyprinus</i> spp., <i>Carassius</i> spp., <i>Ctenopharyngodon idellus</i> , <i>Hypophthalmichthys</i> spp., <i>Cirrhinus</i> spp., <i>Mylopharyngodon piceus</i> , <i>Catla catla</i> , <i>Labeo</i> spp., <i>Osteochilus basselti</i> , <i>Leptobarbus hoeveni</i> , <i>Megalobrama</i> spp.), të gjalla.
ex 0301 99 11	Salmoni i Paqësorit (<i>Oncorhynchus nerka</i> , <i>Oncorhynchus gorbuscha</i> , <i>Oncorhynchus keta</i> , <i>Oncorhynchus tshawytscha</i> , <i>Oncorhynchus kisutch</i> , <i>Oncorhynchus masou</i> e <i>Oncorhynchus rhodurus</i>), salmoni i Atlantikut (<i>Salmo salar</i>) e salmoni i Danubit (<i>Hucho hucho</i>), të gjallë, të peshkuar në ujërat e ëmbla.
0301 99 17	Peshq të tjerë të ujërave të ëmbla, të gjallë.
ex 0302 11	Troftat (<i>Salmo trutta</i> , <i>Oncorhynchus mykiss</i> , <i>Oncorhynchus clarki</i> , <i>Oncorhynchus aguabonita</i> , <i>Oncorhynchus gilae</i> , <i>Oncorhynchus apache</i> e <i>Oncorhynchus chrysogaster</i>), të freskëta ose të ftohta, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304, të peshkuara në ujërat e ëmbla.
ex 0302 13 00	Salmoni i Paqësorit (<i>Oncorhynchus nerka</i> , <i>Oncorhynchus gorbuscha</i> , <i>Oncorhynchus keta</i> , <i>Oncorhynchus tshawytscha</i> , <i>Oncorhynchus kisutch</i> , <i>Oncorhynchus masou</i> e <i>Oncorhynchus rhodurus</i>), të freskët ose të ftohtë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304, të peshkuar në ujërat e ëmbla.
ex 0302 14 00	Salmoni i Atlantikut (<i>Salmo salar</i>) dhe salmoni Danubit (<i>Hucho hucho</i>), të freskët ose të ftohtë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304, të peshkuar në ujërat e ëmbla.
ex 0302 19 00	Salmonidë të tjerë, të freskët ose të ftohtë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304, të peshkuar në ujërat e ëmbla.
0302 71 00	Tilapia (<i>Oreochromis</i> spp.), të freskëta ose të ftohta, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të kreut 0304.
0302 72 00	Peshku mace (<i>Pangasius</i> spp., <i>Silurus</i> spp., <i>Clarias</i> spp., <i>Ictalurus</i> spp.), të freskëta ose të ftohta, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304.
0302 73 00	Krapi (<i>Cyprinus</i> spp., <i>Carassius</i> spp., <i>Ctenopharyngodon idellus</i> , <i>Hypophthalmichthys</i> spp., <i>Cirrhinus</i> spp., <i>Mylopharyngodon piceus</i> , <i>Catla catla</i> , <i>Labeo</i> spp., <i>Osteochilus basselti</i> , <i>Leptobarbus hoeveni</i> , <i>Megalobrama</i> spp.), të freskët ose të ftohtë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304.



ex 0302 74 00	<i>Anguilla</i> (<i>Anguilla</i> spp.), të freskëta ose të ftohta, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304, të peshkuara në ujërat e ëmbla.
0302 79 00	<i>Persico</i> i Nilit (<i>Lates niloticus</i>) e peshk kokëgjarpër (<i>Channa</i> spp.), të freskët ose të ftohtë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304.
0302 89 10	Peshq të tjerë të ujërave të ëmbla, të freskëta ose të ftohta, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304.
ex 0303 11 00	Salmoni i kuq (<i>Oncorhynchus nerka</i>), të ngrirë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304, të peshkuara në ujërat e ëmbla.
ex 0303 12 00	Salmonë të tjerë të Paqësorit (<i>Oncorhynchus gorbuscha</i> , <i>Oncorhynchus keta</i> , <i>Oncorhynchus tshawytscha</i> , <i>Oncorhynchus kisutch</i> , <i>Oncorhynchus mason</i> e <i>Oncorhynchus rhodurus</i>), të ngrirë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304, të peshkuara në ujërat e ëmbla.
ex 0303 13 00	Salmoni e Atlantikut (<i>Salmo salar</i>) dhe salmoni i Danubit (<i>Hucho bucho</i>), të ngrirë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304, të peshkuara në ujërat e ëmbla.
ex 0303 14	Troftat (<i>Salmo trutta</i> , <i>Oncorhynchus mykiss</i> , <i>Oncorhynchus clarki</i> , <i>Oncorhynchus aguabonita</i> , <i>Oncorhynchus gilae</i> , <i>Oncorhynchus apache</i> e <i>Oncorhynchus chrysogaster</i>), të ngrira, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304, të peshkuara në ujërat e ëmbla.
ex 0303 19 00	Salmonidë të tjerë, të ngrirë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304, të peshkuara në ujërat e ëmbla.
0303 23 00	Tilapia (<i>Oreochromis</i> spp.), të ngrirë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304.
0303 24 00	<i>Pesci gatto</i> (<i>Pangasius</i> spp., <i>Silurus</i> spp., <i>Clarias</i> spp., <i>Ictalurus</i> spp.), të ngrirë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304.
0303 25 00	Familja e krapit (<i>Cyprinus</i> spp., <i>Carassius</i> spp., <i>Ctenopharyngodon idellus</i> , <i>Hypophthalmichthys</i> spp., <i>Cirrhinus</i> spp., <i>Mylopharyngodon piceus</i> , <i>Catla catla</i> , <i>Labeo</i> spp., <i>Osteochilus hasselti</i> , <i>Leptobarbus hoeveni</i> , <i>Megalobrama</i> spp.), të ngrirë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304.
ex 0303 26 00	Ngjala (<i>Anguilla</i> spp.), të ngrira, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304, të peshkuara në ujërat e ëmbla.
0303 29 00	<i>Persico</i> i Nilit (<i>Lates niloticus</i>) e peshqve kokëgjarpër (<i>Channa</i> spp.), të ngrirë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304.
0303 89 10	Peshq të tjerë të ujërave të ëmbla, të ngrirë, duke përjashtuar filetat e peshkut dhe mishin e peshkut tjetër të zërit 0304.
0304 31 00	Fileto, të freskëta ose të ftohta, i tilapia (<i>Oreochromis</i> spp.).
0304 32 00	Filetat, të freskëta ose të ftohta, të peshqve mace (<i>Pangasius</i> spp., <i>Silurus</i> spp., <i>Clarias</i> spp., <i>Ictalurus</i> spp.).
0304 33 00	Fileto, të freskëta ose të ftohta, të <i>persico</i> e Nilit (<i>Lates niloticus</i>).
ex 0304 39 00	Fileto, të freskëta ose të ftohta, të familjes së krapit (<i>Cyprinus</i> spp., <i>Carassius</i> spp., <i>Ctenopharyngodon idellus</i> , <i>Hypophthalmichthys</i> spp., <i>Cirrhinus</i> spp., <i>Mylopharyngodon piceus</i> , <i>Catla catla</i> , <i>Labeo</i> spp., <i>Osteochilus hasselti</i> , <i>Leptobarbus hoeveni</i> , <i>Megalobrama</i> spp.), ngjala (<i>Anguilla</i> spp.), të peshkuara në ujërat e ëmbla, e peshqit kokëgjarpër (<i>Channa</i> spp.).
ex 0304 41 00	Fileto, të freskëta ose të ftohta, të salmonit të Paqësorit (<i>Oncorhynchus nerka</i> , <i>Oncorhynchus gorbuscha</i> , <i>Oncorhynchus keta</i> , <i>Oncorhynchus tshawytscha</i> , <i>Oncorhynchus kisutch</i> , <i>Oncorhynchus mason</i> e <i>Oncorhynchus rhodurus</i>), salmoni i Atlantikut (<i>Salmo salar</i>) dhe salmoni i Danubit (<i>Hucho bucho</i>), të peshkuara në ujërat e ëmbla.
ex 0304 42	Fileto, të freskëta ose të ftohta, të troftës (<i>Salmo trutta</i> , <i>Oncorhynchus mykiss</i> , <i>Oncorhynchus clarki</i> , <i>Oncorhynchus aguabonita</i> , <i>Oncorhynchus gilae</i> , <i>Oncorhynchus apache</i> e <i>Oncorhynchus chrysogaster</i>), të peshkuara në ujërat e ëmbla.
0304 49 10	Fileto, të freskëta ose të ftohta, të peshqve të tjerë të ujërave të ëmbla.
ex 0304 51 00	Mishi i peshkut (qoftë i grirë apo jo), përveç fileteve të peshkut, i freskët apo i ftohtë, i tilapia (<i>Oreochromis</i> spp.), peshku mace (<i>Pangasius</i> spp., <i>Silurus</i> spp., <i>Clarias</i> spp., <i>Ictalurus</i> spp.), familjes së krapit (<i>Cyprinus</i> spp., <i>Carassius</i> spp., <i>Ctenopharyngodon idellus</i> , <i>Hypophthalmichthys</i> spp., <i>Cirrhinus</i> spp., <i>Mylopharyngodon piceus</i> , <i>Catla catla</i> , <i>Labeo</i> spp., <i>Osteochilus hasselti</i> , <i>Leptobarbus hoeveni</i> , <i>Megalobrama</i> spp.), <i>anguille</i> (<i>Anguilla</i> spp.), të peshkuara në ujërat e ëmbla, <i>persico</i> i Nilit (<i>Lates niloticus</i>) e peshk kokëgjarpër (<i>Channa</i> spp.).
INDONESIA	(a) dhe (b): — Drejtuesi i Shërbimeve Detare dhe të Peshkimit, Drejtori i Përgjithshëm Rajonal i Peshkimit të Kapjes (c): — Drejtuesi i Portit të Peshkimit, Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit të Kapjes — Inspektori i Peshkimit, Drejtoria e Përgjithshme për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Burimeve Detare të Peshkimit (d): — Drejtori i Përgjithshëm i Mbikëqyrjes së Burimeve Detare dhe të Peshkimit (e): — Drejtori i Përgjithshëm i Peshkimit të Kapjes (f) dhe (g): — Drejtori i Përgjithshëm i Përpunimit dhe Marketingut të Produkteve të Peshkimit
BREGU I FILDISHTE	(a): — Drejtori i Përgjithshëm i Çështjeve Detare dhe Portuale (DGAMP, Sekretariat Shtetëror pranë Ministrisë të Transportit, përgjegjës për çështjet detare dhe portuale) (b): — Ministri i Burimeve Blegtorale dhe Peshkore (c) dhe (e): — Ministri i Burimeve Blegtorale dhe Peshkore — Drejtori i Peshkimit, Drejtoria e Peshkimit — Shefi i Shërbimit të Inspektimit dhe Kontrollit në Kufij (Shërbimi i Inspektimit dhe Kontrollit Sanitar-Veterinar në Kufij, <i>SICOSAV</i>) (d): — Ministri i Burimeve Blegtorale dhe Peshkore — Drejtori i Peshkimit, Drejtoria e Peshkimit (f) dhe (g): — Ministri i Burimeve Blegtorale dhe Peshkore
XHAMAJKA	(a): — Autoriteti Detar i Xhamajkës (MAJ) (b) deri në (g): — Divizioni i Peshkimit
JAPONIA	(a): — Divizioni i Menaxhimit të Peshkimit, Zyra e Peshkimit, Departamenti i Peshkimit dhe Pyjeve, Qeveria e Hokkaido — Qeveria Prefekturale e <i>Aomori</i>-t — Zyra e Peshkimit <i>Hachinohe</i>, Zyra e Administratës së Rajonit <i>Sanpachi</i>, Qeveria Prefekturale e <i>Aomori</i>-t — Zyra e Peshkimit <i>Mutsu</i>, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Zyra e Administratës së Rajonit <i>Seihoku</i>, Qeveria Prefekturale e <i>Aomori</i>-t — Zyra e Peshkimit <i>Ajigasawa</i>, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Zyra e Administratës së Rajonit <i>Seihoku</i>, Qeveria Prefekturale e <i>Aomori</i>-t — Divizioni i Promovimit të Industrisë së Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale <i>Iwate</i> — Departamenti i Peshkimit, Zyra e Promovimit Rajonal Kuji, Qeveria Prefekturale <i>Iwate</i> — Departamenti i Peshkimit, Zyra e Promovimit Rajonal <i>Miyako</i>, Qeveria



Prefekturale Iwate

— Departamenti i Peshkimit, Zyra e Promovimit Rajonal *Kamaishi*, Qeveria Prefekturale *Iwate*

— Departamenti i Peshkimit, Zyra e Promovimit Rajonal Ofunato, Qeveria Prefekturale *Iwate*

— Divizioni i Promovimit të Industrisë së Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Miyagi*

— Divizioni i Peshkimit dhe Porteve të Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Akita*

— Divizioni i Peshkimit, Departamenti i Çështjeve Industriale dhe Ekonomike, Zyra e Degës së Përgjithshme *Shonai*, Qeveria Prefekturale *Yamagata*

— Divizioni i Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Fukushima*

— Zyra e Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Fukushima*

— Divizioni i Administratës së Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Ibaraki*

— Divizioni i Promovimit të Industrive Detare, Qeveria Prefekturale *Chiba*

— Seksioni i Peshkimit, Divizioni i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Zyra e Çështjeve Industriale dhe të Punës, Qeveria Metropolitane e Tokios

— Divizioni i Peshkimit, Departamenti i Mjedisit dhe Bujqësisë, Qeveria Prefekturale *Kanagawa*

— Divizioni i Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Niigata*

— Divizioni i Promovimit, Departamenti i Promovimit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Zyra e Promovimit Rajonal Sado, Qeveria Prefekturale *Niigata*

— Divizioni i Peshkimit dhe Porteve të Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Toyama*

— Divizioni i Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Ishikawa*

— Divizioni i Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Fukui*

— Zyra e Promovimit Rajonal *Reinan*, Qeveria Prefekturale *Fukui*

— Zyra e Menaxhimit të Peshkimit, Divizioni i Peshkimit, Departamenti i Industrisë, Qeveria Prefekturale *Shizuoka*

— Divizioni i Administratës së Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Aichi*

— Zyra e Burimeve të Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Peshkimit, Tregtisë dhe Industrisë, Qeveria Prefekturale *Mie*

— Divizioni i Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Kyoto*

—

—

— Zyra e Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Kyoto*

— Divizioni i Peshkimit, Departamenti i Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Osaka*

— Divizioni i Peshkimit, Zyra e Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Qeveria Prefekturale *Hyogo*

— Zyra e Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit Kobe, Zyra e Administratës Rajonale *Kobe*, Qeveria Prefekturale *Hyogo*

— Zyra e Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit Kakogawa, Zyra e Administratës Rajonale Higashi-Harima, Qeveria Prefekturale *Hyogo*



— Zyra e Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit Himeji, Zyra e Administratës Rajonale Naka-Harima, Qeveria Prefekturale *Hyogo*

— Zyra e Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit Koto, Zyra e Administratës Rajonale Nishi-Harima, Qeveria Prefekturale *Hyogo*

— Zyra e Peshkimit Tajima, Zyra e Administratës Rajonale Tajima, Qeveria Prefekturale *Hyogo*

— Zyra e Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit Sumoto, Zyra e Administratës Rajonale *Anaji*, Qeveria Prefekturale *Hyogo*

— Qeveria Prefekturale *Wakayama*

— Zyra e Promovimit Kaisou, Qeveria Prefekturale *Wakayama*

— Zyra e Promovimit Arida, Qeveria Prefekturale *Wakayama*

— Zyra e Promovimit Hidaka, Qeveria Prefekturale *Wakayama*

— Zyra e Promovimit Nishimuro, Qeveria Prefekturale *Wakayama*

— Zyra e Promovimit Higashimuro, Qeveria Prefekturale *Wakayama*

— Divizioni i Peshkimit, Zyra e Zhvillimit të Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Tottori*

— Divizioni i Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Shimane*

— Zyra e Peshkimit, Degë *Oki*, Qeveria Prefekturale *Shimane*

— Zyra e Peshkimit Matsue, Qeveria Prefekturale *Shimane*

— Zyra e Peshkimit Hamada, Qeveria Prefekturale *Shimane*

— Qeveria Prefekturale *Okayama*

— Qeveria Prefekturale *Hiroshima*

— Divizioni i Promovimit të Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Yamaguchi*

— Divizioni i Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Tokushima*

— Divizioni i Peshkimit, Departamenti i Administratës Bujqësore dhe i Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Kagawa*

— Divizioni i Promovimit të Peshkimit, Zyra e Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Ehime*

— Divizioni i Menaxhimit të Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Kochi*

— Divizioni i Administratës së Peshkimit, Zyra e Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Fukuoka*

— Divizioni i Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Saga*

— Divizioni i Menaxhimit të Burimeve, Departamenti i Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Nagasaki*

— Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Kumamoto*

— Zyra e Promovimit Rajonal Tamana, Qeveria Prefekturale *Kumamoto*

— Zyra e Promovimit Rajonal Yatsushiro, Qeveria Prefekturale *Kumamoto*

— Zyra e Promovimit Rajonal Amakusa, Qeveria Prefekturale *Kumamoto*

— Qeveria Prefekturale *Oita*

— Divizioni i Administratës së Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Miyazaki*

— Divizioni i Promovimit të Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Kagoshima*

— Divizioni i Peshkimit, Departamenti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qeveria Prefekturale *Okinawa*

— Divizioni i Menaxhimit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qendra Rajonale Miyako, Qeveria Prefekturale *Okinawa*

— Divizioni i Menaxhimit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit, Qendra Rajonale *Yaeyama*, Qeveria Prefekturale *Okinawa*



URDHËR

Nr. 563, datë 3.11.2025

**PËR RAPORTIMIN E TË DHËNAVE
DHE ECURISË SË ÇËSHTJEVE
GJYQËSORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Arsimit”,

URDHËROJ:

1. Juristët e Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore, si dhe nëpunësit përgjegjës për përfaqësimin ligjor në institucionet e varësisë dhe/ose degët e tyre territoriale, raportojnë të dhënat për çështjet gjyqësore që kanë në ndjekje, duke pasqyruar nëpërmjet një format tabelle:

a) numrin e çështjes në regjistrin elektronik të ministrisë/institucionit të varësisë;

b) numrin e aktit;

c) palët ndërgjyqëse;

d) objektin e çështjes;

e) gjykatën dhe gjyqtarin/gjyqtarët aktual të çështjes;

f) ecurinë e gjykimit dhe zhvillimet gjatë seancave përgatitore/gjyqësore;

g) planifikimin e gjykimit dhe fazën procedurale pasardhëse;

h) rezultatin e çështjes (dispozitivi i vendimit, numri dhe data e vendimit);

i) klasifikimin e çështjes sipas kodit “A”;

j) problematika të evidentuara gjatë gjykimit;

k) dëmin e parandaluar apo të shkaktuar (në vlerë dhe në sipërfaqe m²);

l) datën e ankimit/rekursit;

m) informacionin e shkurtuar të rezultatit të çështjes (fituar, humbur, fituar pjesërisht, jashtë juridiksioni, jashtë kompetence, pushuar, pezulluar, kthim aktesh, rigjykim, deleguar, relatuar).

2. Raportimi kryhet sipas tabelës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij urdhri, dhe informacioni i shkurtuar pasqyrohet sipas përcaktimit në shkronjën “m”, të pikës 1 të këtij urdhri.

3. Në çështjet gjyqësore në të cilat kërkohet “marrja e masës së sigurimit të padisë” apo “sigurimi i provës”, të cilat kanë afate të shkurtra kohore, raportohet menjëherë me marrjen në dijeni të tyre pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe personit të kontaktit të caktuar për koordinimin e mbrojtjes me Avokaturën e Shtetit.

4. Tabela bashkëlidhur këtij urdhri do të përmbajë informacionin për të gjitha çështjet gjyqësore të ndjekura brenda një viti pune dhe do të përsëritet në fillim të çdo viti, duke pasqyruar çështjet e mbartura, të ankimuara dhe çështjet e reja. Numri rendor i çështjeve në tabelën raportuese duhet të mbetet i njëjtë deri në fund të vitit.

5. Juristët e Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore, si dhe nëpunësit përgjegjës për ndjekjen e proceseve gjyqësore në institucionet e varësisë dhe/ose degët e tyre territoriale, dërgojnë në adresat zyrtare elektronike të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe personit të kontaktit tabelën e raportimit çdo ditë të premte të javës, duke përditësuar ecurinë gjatë javës dhe planifikimin për javën pasardhëse. Në rastet kur e premja është ditë feste zyrtare, raportimi duhet të kryhet ditën pararendëse.

6. Brenda datës 5 (pesë) të çdo muaji, juristët e Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore dhe nëpunësit e institucioneve të varësisë dhe/ose degët e tyre territoriale, të cilët kryejnë përfaqësimin ligjor, dërgojnë në adresat zyrtare elektronike të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe personit të kontaktit, raportim të detajuar mbi ecurinë e të gjitha çështjeve të mbartura, në proces dhe të përfunduara gjatë muajit, dhe planifikimin për secilën çështje.

7. Ngarkohen të gjitha strukturat e aparatit të Ministrisë së Arsimit, dhe institucionet në varësi të saj, për zbatimin e këtij urdhri si dhe Sektori i Arkiv/Protokollit për komunikimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi



URDHËR

Nr. 1089, datë 3.11.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”; në nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 870 datë 14.12.2021, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si vijon:

a) realizimin e procedurave të prokurimit publik me fondet buxhetore të institucionit;

b) nënshkrimin e kontratave administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme jashtë qendrës së punës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në largësi mbi 100 km, si dhe me shërbim jashtë vendit.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 50, datë 1.2.2024, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Elisa Spiropali

URDHËR

Nr. 1090, datë 3.11.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS SË
MINISTRIT PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME MBI ÇËSHTJET
KONSULLORE

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 22 e vijues, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; ligjin nr. 8372, datë 9.7.1998, “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga Përfaqësitë Diplomatie ose Konsullore”, ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore sipas përcaktimeve të këtij urdhri.

2. Drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore i delegohet kompetenca për ndjekjen dhe nënshkrimin e shkresave si më poshtë:

a) përcjellje e akteve të gjendjes civile, lejeve të drejtimit, pasaportave e sendeve të humbura, specimene të dokumenteve shqiptare apo të huaja;

b) verifikim dokumentacioni të lëshuar nga institucionet shqiptare:

- për identitetin e shtetasit shqiptarë,

- për figurën e kandidatit për konsuj nderi të RSH-së dhe të huaj;

c) kërkesat për çelje-mbyllje aksesesh për diplomatët, operatorët tek Identitek, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë;

d) shkresat shoqëruese për postën diplomatike që përmban pasaporta dhe materiale të Identitek-ut;

e) përcjellje praktikash për heqjen dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare;

f) përcjellje kërkesash për ekstradim, ndihmë juridike, ndalim, arrestim për shtetas shqiptar e të huaj.

3. Sekretarit të Përgjithshëm i delegohet kompetenca për nënshkrimin e të gjithë akteve të



tjera me karakter konsullor, që nuk përfshihen në pikën 2 të këtij urdhri.

4. Njoftimet dhe komunikimet elektronike për çështjet konsullore i drejtohen drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, duke vënë në dijeni Sekretarin e Përgjithshëm.

5. Të gjitha njoftimet/publikimet e aktiviteteve/njoftimeve konsullore në faqet apo logaritë zyrtare të rrjeteve sociale të MEPJ-së, si dhe të misioneve diplomatike/posteve konsullore të RSH-së bëhen me miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm, me propozim të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, në bashkëpunim me kabinetin e ministrit.

6. Titullarët e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë i raportojnë për veprimtarinë konsullore, në basë ditore, drejtorit të drejtorisë që i mbulon çështjet konsullore.

7. Drejtori i drejtorisë që mbulon çështjet konsullore i raporton, në bazë ditore, veprimtarinë konsullore, të ushtruar nga përfaqësitë/postet konsullore, Sekretarit të Përgjithshëm.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, titullarët dhe punonjësit konsullorë në misionet diplomatike dhe postet konsullore të RSH-së, si dhe drejtorja e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror.

9. Ky urdhër i njoftohet strukturave të ngarkuara dhe misioneve diplomatike e konsullore nga Sektori i Menaxhimit të Dokumentacionit në Drejtorinë e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror.

10. Urdhri nr. 311, datë 3.5.2024, “Për delegimin e kompetencës për trajtimin e çështjeve konsullore”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Elisa Spiropali

URDHËR

Nr. 1091, datë 3.11.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS SË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME NË PROCESET GJYQËSORE

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; nenet 22 e vijues, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për përfaqësimin ligjor të institucionit në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore të nënshkruhen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit apo personave që përfaqësojnë institucionin.

3. Përfaqësuesi i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara gjykatave, prokurorisë, zyrave të përmbarimit gjyqësor, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

4. Të gjitha aktet e nënshkruara përpara hyrjes në fuqi të këtij urdhri dhe që janë nxjerrë në zbatim të urdhrit nr. 51, datë 1.2.2024, “Për delegim kompetencash”, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e procesit gjyqësor përkatës.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 51, datë 1.2.2024, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Elisa Spiropali
Faqe | 24789



URDHËR

Nr. 1095, datë 30.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Rumanisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Caraș-Severin	Buchin*	
Caraș-Severin	Gorua*	
Gorj	Calnic*	
Sibiu	Cisnădie*	
Timiș	Liebling*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me

nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët.

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo



28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuar para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe

embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 1017, datë 15.10.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Rumanisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1096, datë 30.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Hungarisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Baranya	Szigetvár*	
Borsod-Abaúj-Zemplén	Sátoraljaújhely*	
Somogy	Kadarkút*	



Somogy	Kaposvár*	
Vas	Sárvár*	
Vas	Szentgotthárd*	
Veszprém	Ajka*	
Veszprém	Tapolca*	
Zala	Lenti*	
Zala	Zalaegerszeg*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. Kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) Janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të



Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 1046, datë 20.10.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 1097, datë 30.10.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Susz*
Warmińsko-Mazurskie	Kętrzyn	Reszel*
Wielkopolskie	Ostrzeszów	Mikstat*
Wielkopolskie	Turek	Kawęczyn*
Wielkopolskie	Turek	Przykona*
Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Grunwald*
Wielkopolskie	Konin	Rzgów*
Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Pozezdrze*
Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Ilawa (rural)*
Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Zalewo*
Malopolskie	Tarnów	Wojnicz*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjitha subjektet importuese të



shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1086, datë 27.10.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1098, datë 30.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ITALISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr.

10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Povoletto*
Veneto	Verona	Oppeano*
Veneto	Verona	Isola Della Scala*
Piemonte	Alessandria	Occimiano*
Emilia-Romagna	Bologna	Minerbio*
Emilia-Romagna	Forlì - Cesena	Forlì*
Emilia-Romagna	Parma	Sorbolo*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve



për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1085, datë 27.10.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1099, datë 30.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HOLANDËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- e) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
Drenthe	Aa en Hunze*
Gelderland	Kesteren*
Gelderland	Hummelo en Keppel

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1084, datë 27.10.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla



URDHËR

Nr. 1100, datë 30.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E LITUANISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontenier të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Panevezio	Panevëzio*	
Klaipėdos*		
Marijampolės*		
Šiauliai	Akmenės*	
Šiauliai	Šiaulių*	
Šiauliai	Kelmės*	
Šiauliai	Joniškio*	
Šiauliai	Pakruojis*	
Šiauliai	Radviliskio*	
Taurages	Tauragės*	
Taurages	Jurbarko*	
Taurages	Šilalės*	
Telsiai	Telsių*	
Telsiai	Plungės*	
Vilniaus	Vilniaus*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij,

materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Lituanisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetohet që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetohet që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muajt, vetëm nëse survejancat demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetohet që kafshët donatore të embrioneve:**



a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërtetohet se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujt 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat, në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërtetohet se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ITALISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Povoletto*
Veneto	Verona	Oppeano*
Veneto	Verona	Isola Della Scala*

Piemonte	Alessandria	Occimiano*
Emilia-Romagna	Bologna	Minerbio*
Emilia-Romagna	Forlì - Cesena	Forlì*
Emilia-Romagna	Parma	Sorbolo*
Lombardia	Lodi	Zelo Buon Persico*
Lombardia	Cremona	Casale Cremasco-Vidolascio*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1098, datë 30.10.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla



URDHËR

Nr. 1118, datë 3.11.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HUNGARISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
Jász-Nagykun-Szolnok	Szolnok*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 1119, datë 3.11.2025

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT
NR. 925, DATË 25.9.2025, “PËR DISA
MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES
SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ARGJENTINËS”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 925, datë 25.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Argjentinës”.



2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

VENDIM
Nr. 57, datë 14.10.2025

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datat 25.9.2025 dhe 14.10.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 14 (E) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Elton Qyno, përfaqësuar nga avokat Dorian Matlija, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Avokatura e Shtetit, në mungesë.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në mungesë.

OBJEKTI: Plotësimi i vendimit nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Neni 313 i Kodit të Procedurës Civile (KPC); neni 80, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim prapësimet me shkrim të kërkuarit Elton Qyno (*kërkuari*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Avokaturës së Shtetit dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Në datën 14.6.2024, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore për lejimin e kontroleve personale dhe të vendeve (banesë dhe vendi i punës), vendimeve gjyqësore për sekuestrimin e provave materiale (sende dhe të dhëna kompjuterike) dhe vendimit të prokurorit për sekuestrimin e dy aparateve telefonike, si dhe shkatërrimin e të gjitha kopjeve të të dhënave të nxjerra nga pajisjet e sekuestruara. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 23.7.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, por në seancën plenare të datës 5.3.2025 Gjykata e ka ndryshuar formën e shqyrtimit të çështjes në atë publike, me praninë e palëve.

2. Në parashtrimet përpara seancës së datës 2.4.2025, kërkuari, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, ka kërkuar rimbursimin e shpenzimeve të përfaqësimit në masën 263.500 lekë në rastin eventual të pranimit të ankimit kushtetues individual. Këtë kërkim ai e ka përsëritur edhe në konkluzionet përfundimtare të seancës së datës 10.4.2025.

3. Në përfundim të gjykimit kushtetues, Gjykata, me vendimin nr. 21, datë 22.4.2025 (*vendimi nr. 21/2025*) vendosi pranimin e pjesës së kërkesës, shfuqizimin e vendimeve gjyqësore që kanë lejuar sekuestrimin e të dhënave kompjuterike të nxjerra nga provat materiale të sekuestruara gjatë kontrollit të banesës dhe të vendit të punës së kërkuarit, si dhe asgjësimin e të dhënave kompjuterike të sekuestruara me këto vendime. Vendimi nr.



21/2025 i Gjykatës është shpallur në datën 21.5.2025 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 89, datë 26.5.2025.

4. Në datën 28.5.2025, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë, me objekt plotësimin e vendimit nr. 21/2025, lidhur me shpenzimet e përfaqësimit. Kolegji i Gjykatës, në datën 8.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi nr. 21/2025 i Gjykatës duhet të plotësohet me disponimin për rimbursimin e shpenzimeve të përfaqësimit, sipas faturës tatimore të lëshuar nga avokati. Ato shpenzime janë reale dhe të nevojshme për mbrojtjen e lirisë së shprehjes së kërkuesit si gazetar, që përbënte çështje komplekse në hartimin e ankimit kushtetues individual dhe përfaqësimin në seancë.

6. **Subjektet e interesuara, Avokatura e Shtetit dhe Prokuroria e Posaçme**, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

7. Në rastet kur Gjykata vihet në lëvizje për plotësimin e vendimit të saj, legjitimimi i kërkuesit dhe procedura parashikohen në nenin 80, të ligjit nr. 8577/2000. Sipas kësaj dispozite, Gjykata ka të drejtë, me kërkesë, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. Vendimi i Gjykatës në këto raste publikohet në Fletoren Zyrtare. I njëjti rregull parashikohet edhe në nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullorja*), sipas të cilit kur kërkesa ka të bëjë me një vendim përfundimtar, kompetente për shqyrtimin e saj është Gjykata.

8. Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata çmon se në rastin konkret kërkuesi legjitimohet në paraqitjen e kërkesës sipas objektit, pasi ka qenë palë pjesëmarrëse në gjykimin për të cilin është dhënë vendimi nr. 21/2025 i Gjykatës dhe i është drejtuar asaj në datën 28.5.2025, pra brenda 2 muajve nga

data 21.5.2025, kur është shpallur vendimi. Po kështu, kërkimi për të plotësuar vendimin edhe me disponimin për shpenzimet gjyqësore, sipas nenit 28, të ligjit nr. 8577/2000, hyn në kompetencën lëndore të Gjykatës të përcaktuar nga neni 80 i të njëjtit ligj, i cili emërtohet "*Saktësimi dhe plotësimi i vendimit*", pasi është kërkim i paraqitur në parashtrimet shtesë të ankimit kushtetues individual të parë dhe nuk ndryshon thelbin e vendimarrjes, ndaj, në vijim, Gjykata do ta analizojë atë në themel.

9. E drejta për të kërkuar shpenzimet e përfaqësimit parashikohet në nenin 28, të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit shpenzimet e procesit gjyqësor u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore (*pika 1*), dhe kur vendoset pranimi i ankimit kushtetues individual, Gjykata mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi (*pika 2*). Kjo dispozitë është konkretizuar në nenin 14 të Rregullores, që përcakton se kur Gjykata vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, ajo shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (*pika 4*).

10. Gjykata ka pohuar se çështja e shpenzimeve gjyqësore është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe refuzimi për mbulimin e tyre kufizon në mënyrë të pajustificuar të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri kur deklarohet mbyllja e seancës plenare nga Gjykata. Individi ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërteton se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe në masë të arsyeshme, ndaj ai duhet të paraqesë edhe aktet që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të kërkuesit, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar (*shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).



11. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesi është përfaqësuar nga i njëjti avokat që në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual fillestar (14.6.2024), ndërsa kërkesën për pagesën e shpenzimeve të përfaqësimit e ka parashtruar në parashtrimet para seancës publike të datës 2.4.2025 dhe përsëritur në konkluzionet e datës 10.4.2025, duke paraqitur edhe faturën tatimore. Kjo e fundit përmban vlerën e përgjithshme prej 263.500 lekësh, si rezultat i vlerës për përfaqësimin në gjykimin kushtetues (186.000 lekë) dhe asaj për paraqitjen e kërkesës (77.500 lekë). Kërkuesi ka argumentuar se shpenzimet e pasqyruara në faturën tatimore të fiskalizuar janë reale dhe ato janë të nevojshme, pasi në themel të ankimit kushtetues individual fillestar qëndronte vlefshmëria e një mase hetimore që prekte lirinë e shprehjes së kërkuesit si gazetar. Sipas tij, çështja ishte komplekse, pasi kërkonte hartimin e ankimit kushtetues individual sipas standardeve kushtetuese dhe evropiane, analizën krahasimore me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), analizën e ligjshmërisë së masave të veprimeve hetimore dhe trajtimin e parimeve kushtetuese dhe konventore të zbatueshme në rastin e kërkuesit, të cilat kërkojnë ndihmë profesionale. Po sipas kërkuesit, koha e shpenzuar për këtë çështje ka qenë mbi 120 orë pune, ndonëse në faturën tatimore janë pasqyruar vetëm 20-50 orë. Kërkuesi mund të kërkojë rimbursimin e shpenzimeve të përfaqësimit vetëm pranë saj, ndërkohë shpenzimet në shkallët më të ulëta të gjyqësorit mbeten të pakompensuara për shkak të natyrës së gjyqimit penal.

12. Për sa më lart, Gjykata çmon se kërkimi i kërkuesit për shpenzimet gjyqësore është paraqitur brenda afatit, pasi ai është depozituar përpara marrjes së vendimit për pranimin e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me masën, Gjykata, duke marrë në konsideratë faktin se gjykimi kushtetues i përfunduar me vendimin nr. 21/2025 ka qenë relativisht kompleks, se çështja ka të bëjë me kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të fazës së hetimit penal, numrin e seancave të zhvilluara në Gjykatë dhe zhvillimin e disa prej tyre në seancë publike me praninë e palëve, mungesën e formimit dhe të përvojës juridike për të kuptuar çështjen (profesion gazetar), si dhe numrin e pretendimeve të pranuar nga Gjykata, vlerëson masën e shpenzimeve të përfaqësimit në vlerën 200.000 lekë.

13. Për sa i përket subjektit që ngarkohet për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit, Gjykata ka vënë në dukje se në gjykimin kushtetues individ i kërkon të mbrojë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, që i kanë pasjellë atij cenimin e të drejtave themelore, ndaj përgjegjësia në këtë gjykim i takon vetë shtetit (*shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se detyrimi për pagimin e shpenzimeve të përfaqësimit duhet t'i ngarkohet Ministrisë së Financave.

14. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa për shpenzimet e përfaqësimit është e drejtë dhe duhet pranuar pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 80, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Plotësimin e vendimit nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese në dispozitivin e tij si më poshtë:

“Shpenzimet e përfaqësimit të kërkuesit në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave.”.

3. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit përfundimtar nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 14.10.2025.

Shpallur më 4.11.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini



VENDIM

Nr. 258, datë 21.10.2025

**MBI NJOHJEN E LICENCËS PËR
FURNIZIMIN ME ENERGJI
ELEKTRIKE, LËSHUAR NGA ZYRA E
RREGULLATORIT PËR ENERGJI E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR
SUBJEKTIN “MANAGEMENT &
DEVELOPMENT ASSOCIATES LLC”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 97, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pikat 3, 4, 5 dhe 6, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 245, datë 6.12.2021, “Mbi njohjen reciproke të licencave për veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike ndërmjet autoriteteve kombëtare rregullatore të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2410/8 prot., datë 15.10.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, për subjektin ‘Management & Development Associates LLC’”

konstatoi se:

- Subjekti “Management & Development Associates”, degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2412/3 prot., datë 17.9.2025, ka paraqitur kërkesën për njohje të licencës për furnizimin me energji elektrike me numër ZRRE/Li_103/25, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), në datën 10.7.2025, për shoqërinë “Management & Development Associates LLC”, për furnizimin me energji elektrike.

- Në lidhje me këtë aplikim është zhvilluar një korrespondencë pararendëse me email me shoqërinë, ku ajo ka kërkuar informacion mbi procedurën e licencimit/njohjes së licencës dhe i janë dhënë

udhëzimet përkatëse. Në vijim të këtij komunikimi, me email-in e datës 8.9.2025, shoqëria ka pretenduar se në Kosovë, licenca për furnizim e lëshuar nga ZRRE-ja përfshin edhe licencën për tregtim me energji elektrike dhe në këtë kuadër ka kërkuar informacion nëse vlen i njëjti rregull edhe në Shqipëri pas njohjes së licencës nga ERE.

- Për sa më sipër, me email-in e datës 11.9.2025, ERE i është drejtuar ZRRE-së me një kërkesë për interpretim për sa pretenduar nga shoqëria, duke vënë në dijeni dhe shoqërinë për këtë komunikim, e po ashtu duke i kërkuar informacion në rast se licenca me numër ZRRE/Li_103/25, është e vlefshme dhe nëse është marrë ndonjë vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- Pas dërgimit të këtij email-i drejtuar ZRRE-së, në datën 17.9.2025 shoqëria ka depozituar aplikimin e saj si më sipër cituar, duke specifikuar në shtojcën 1 të aplikimit të saj njohjen e licencës vetëm për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, ku pas shqyrtimit paraprak ka rezultuar se ka dokumentacion që nevojitet të plotësohet ende në lidhje me këtë aplikim dhe po ashtu, duke qenë se nuk ishte kryer pagesa e plotë sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores, shoqëria duhet të kryente dhe diferencën përkatëse të pagesës. Në këto rrethana, ERE iu drejtua shoqërisë me email-in e datës 23.9.2025.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2412/6 prot., datë 29.9.2025, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar dhe ka kryer diferencën e pagesës, ku rezulton se shoqëria ka kryer të plotë pagesën që përkon me njohjen e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe se shoqëria është kreditor për një vlerë të vogël, që do të rakordohet në vijim me të. Po ashtu, sa këqyrur nga shtojca e ridepozituar, rezulton se ajo ka plotësuar aplikimin e njohjes për të dyja veprimtaritë, tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike, por duke iu referuar aplikimit fillestar të saj dhe pagesës së kryer nga ana e shoqërisë, që përkon me licencën për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe faktin që nga ana e ZRRE-së nuk ka ende një përgjigje për kërkesën për interpretim, u vlerësua të vijohet me shqyrtimin e aplikimit për njohje të licencës së furnizimit të energjisë elektrike.

- Po ashtu, me email-in e datës 2.10.2025, ZRRE-ja ka informuar se nuk ka filluar dhe as ka ndërmarrë



ndonjë vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- Subjekti ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga neni 4, pika 3 dhe shtojca 1/K, e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Afati i njohjes së licencës do të jetë i njëjtë me afatin e licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, për shoqërinë “*Management & Development Associates LLC*”, deri më 9.7.2030.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike nr. ZRRE/Li_103/25, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës (ZRRE), në datën 10.7.2025, për shoqërinë “*Management & Development Associates LLC*”, për furnizimin me energji elektrike, që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “*Management & Development Associates*”, degë e shoqërisë së huaj.

2. Njohja e licencës sipas përcaktimeve të pikës 1 do të jetë e vlefshme deri më 9.7.2030.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “*Management & Development Associates*”, degë e shoqërisë së huaj, “OST” sh.a., “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 259, datë 21.10.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “PROSOL” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2609/1 prot., datë 16.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Prosol’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Prosol” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2609 prot., datë 10.10.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 21 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas aneksit A.



- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “b” dhe “c”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germës “a”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “b”, “c”, “e”, “d”, “e” dhe “f”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria ka depozituar vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 92, datë 12.2.2025, “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Prosol’ sh.p.k.”

- Shoqëria ka depozituar kontratën nr. 1353 rep., nr. 578 kol., datë 18.3.2025, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 21 mw, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “Prosol” sh.p.k.”, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, shoqërisë “Prosol” sh.p.k.

- Shoqëria ka depozituar “Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaike prosol solar”, të datës 26.6.2025, të nënshkruar mes OST sh.a. dhe shoqërisë “Prosol” sh.p.k.

- Vendimin për VNM paraprake, datë 19.7.2024, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për personin juridik “Prosol” sh.p.k., për të zhvilluar projektin: “Ndërtimi i centralit fotovoltaike prosol solar, 21 mw”, dhënë për kapacitetin 21 Mw.

- Në lidhje me këtë aplikim, vlerësojmë se duhet të sqarohet me shoqërinë duke zhvilluar dhe një seancë dëgjimore, se si është ndjekur nga ana e saj, në paraqitjen e aplikimeve për marrjen e lejeve, apo miratimeve përkatëse nga organet e tjera (si miratimi i OST sh.a. për pikën e lidhjes dhe vendimi për VNM paraprake lëshuar nga AKM-ja), zbatimi i detyrimit të përcaktuar në kontratën e nënshkruar

me MIE-n, në lidhje me kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaike.

Po ashtu, në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- Shoqëria duhet të depozitojë aktin përkatës të përfaqësimit, në lidhje me përfaqësuesin ligjor të përcaktuar nga ana e saj në zbatim të shtojcës 1 (germa “d”).

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës financiar në mbështetje të realizimit të projektit, pasi nuk është depozituar asnjë dokument (germa “b”).

- Shoqëria duhet të ridepozitojë në ERE planin e biznesit, duke bërë parashikimet dhe përcaktimet përkatës për 30 vjet, sa afati i vlefshmërisë së licencës, dhe për kapacitetin 21 mw, sikurse miratuar në kontratën me MIE (germa “c”).

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

Pika 2.1, “Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- Formatin e plotësuar me të dhënat teknike në zbatim të shtojcës 2 (germa “a”);

- Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse për sa u përket njësive gjeneruese dhe kapacitetit të secilës, duke iu referuar kapacitetit total të përcaktuar në kontratën me MIE-n.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Prosol” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 21 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Prosol” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 260, datë 21.10.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“REYTECH TRADING” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, si dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2469/5 prot., datë 16.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Reytech Trading’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Reytech Trading” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2469 prot., datë 17.9.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 247, datë 30.9.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.10.2025 dhe 2.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 2469/2 prot., datë 3.10.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2469/3 prot., datë 7.10.2025 dhe nr. 2469/4 prot., datë 9.10.2025, shoqëria ka depozituar pjesën e mbetur të dokumentacionit e kërkuar.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Nga analizimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Reytech Trading” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Reytech Trading” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,



brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 261, datë 21.10.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“VIVID POWER” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, si dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2467/8 prot., datë 16.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Vivid Power’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Vivid Power” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2467 prot., datë 17.9.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 245, datë 30.9.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.10.2025 dhe 2.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua po ashtu në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 2467/5 prot., datë 3.10.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2467/6 prot., datë 10.10.2025, ka depozituar informacionin/dokumentacionin e konstatuar të munguar të këtij aplikimi.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Nga analizimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të shtojcës A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k., “OST” sh.a., “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 262, datë 21.10.2025****MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“VIVID POWER” SHPK NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “ç” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2467/7 prot., datë 16.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Vivid Power’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Vivid Power” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2467 prot., datë 17.9.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 244, datë 30.9.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.10.2025 dhe 2.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua po ashtu në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 2467/5 prot., datë 3.10.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2467/6 prot., datë 10.10.2025, ka depozituar

informacionin/dokumentacionin e konstatuar të munguar të këtij aplikimi.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Në referencë të përcaktimeve të rregullores, aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për nenin 9, pika 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”; si dhe për pikën 2.4, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Për sa njoftuar nga vetë shoqëria se sistemi IT dhe stafi teknik në strukturën e saj organizative do të bëhen efektive pas licencimit dhe përpara fillimit të aktivitetit të furnizimit të energjisë elektrike, vlerësohet që t’i lihet kusht asaj që me fillimin e operimit, të depozitojë në ERE informacionin e përditësuar për sistemin IT dhe strukturën organizative me stafin teknik efektiv për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria i disponon aktualisht zyrat përfaqësuese të furnizuesit, por duke qenë se afati i kontratës së huapërdorjes përfundon më 4.1.2026 dhe nuk mbulon afatin 5-vjeçar të licencës, vlerësohet t’i lihet kusht asaj që brenda kësaj date të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të huapërdorjes për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara nga Bordi i ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Me fillimin e operimit, shoqëria të depozitojë në ERE informacionin e përditësuar, në lidhje me sistemin IT dhe strukturën organizative me stafin



teknik efektiv për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

3. Brenda datës 4.1.2026, shoqëria të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të huapërdorjes për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3.

5. Drejtorja e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k., “OST” sh.a., “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 263, datë 21.10.2025

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR TRANSFERIMIN NËPËRMJET
VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE
TË ASETEVE FIKSE TË SHOQËRISË
“ERSEKA SOLAR PARK 1” SHPK**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, gerrat “a” dhe “b”, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 193, datë 12.8.2025, “Mbi procedurën e trajtimit të kërkesave të të licencuarve të cilët plotësojnë kriteret ligjore për marrjen e autorizimit nga ERE, për

transferim asetesh në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, që në fazën e parë të aplikimit”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 2573/3 prot., datë 17.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Erseka Solar Park 1’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet 20 mw, në Njësinë Administrative të Qendrës Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë.

- Me shkresën me nr. 2573 prot., datë 3.10.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosje kolateral aset e të licencuarit “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj Banka e Parë e Investimeve – Albania sh.a. dhe First Investment Bank AD, Sofie Bullgari, ku agent i kredisë është zgjedhur Banka e Parë e Investimeve – Albania sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të neneve 2, germa “a”, 3, 5, germa “j” dhe 6, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licencuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të



licencuarit”, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin/informacionin e kërkuar.

3. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- pika 1 – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi kërkesën për transferim, ndër të tjera si më poshtë vijon:

- germa “a” – është depozituar ekstrakti historik i shoqërisë, i vlefshëm brenda afatit ligjor;

- germa “b” – është plotësuar informacioni mbi veprimtarinë e licencuar;

- germa “c” – është plotësuar informacioni mbi gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efekti i pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;

- germa “d” – është bërë një përshkrim i kandidatit;

- germat: “e”, “f” dhe “g” – arsyet e kërkesës, efektet në aktivitetin e licencuar dhe furnizimin e klientëve;

- germa “h” – janë depozituar marrëveshjet përkatëse;

- *kontratë kredie 3298 rep., nr. 1375 kol., datë 1.10.2025, nënshkruar nga palët;*

- *marrëveshje siguruese nr. 3302 rep., nr. 1379 kol., datë 1.10.2025, të nënshkruar nga palët;*

- *kontratën e bashkëpunimit, me nr. 615 rep., nr. 465 kol., datë 6.2.2023, të ndryshuar.*

- germa “i” – deklarata e kredidhënësit për garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit;

- germa “j” – deklarata dhe vërtetimi për mungesë transferimesh të mëparshme mbi asetet fikse;

- pika 3 – është plotësuar informacioni i kërkuar në këtë pikë që lidhet me detyrimet me të cilat ngarkohet subjekti për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferojnë te përfituesi përfshirë edhe informimin e Autoriteti Shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve;

- pika 4 – kërkesa për aplikim është nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërsa dokumentet e tjera shoqëruese të këtij aplikimi janë nënshkruar nga administratori dhe/ose personat e autorizuar sipas rastit;

- pika 6 – shoqëria ka bërë me dije se kërkon të mos jenë të hapura për publikim, për arsye konkurrence, marrëveshja siguruese nr. 3302 rep., nr. 1379 kol., datë 1.10.2025. Megjithatë, vlerësohet se, për arsye ligjore dhe në përputhje me parimin e transparencës së vendimmarrjes publike, disa nga këto elemente, si identiteti i kredidhënësve dhe lista

e aseteve objekt i barrës, janë thelbësore për përmbajtjen e aktit administrativ dhe nuk mund të përjashtohen nga publikimi. Për rrjedhojë, lista e aseteve, duke qenë pjesë përbërëse e vendimit të ERE-s, publikohet së bashku me vendimin përkatës, ndërsa për pjesën tjetër të dokumentacionit do të mbahet në konsideratë konfidencialiteti i tyre nga ana e ERE-s.

- Referuar vendimit të Bordit të ERE-s nr. 193, datë 12.8.2025, ku citohet se për të licencuarit që aplikojnë për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse, dhe që kanë plotësuar gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, që në fazën e parë të aplikimit, Bordi i ERE-s do të shprehet mbi kërkesën për dhënie autorizimi për transferim asetesh brenda 45 ditëve nga aplikimi.

4. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE nuk e çliron shoqërinë nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve/institucioneve të tjera apo palëve të treta për këtë transferim, në rast se kjo kërkohej nga këto organe/institucione.

- Përveç sa më sipër, për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi asetet e shoqërisë për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e saj ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a. dhe “First Investment Bank AD” sh.a., ku agjent i kredisë është zgjedhur Banka e Parë e Investimeve – Albania sh.a., që rrjedhin nga kontrata e kredisë nr. 3298 rep., nr. 1375 kol., datë 1.10.2025 dhe nga marrëveshja siguruese nr. 3302 rep., nr. 1379 kol., datë 1.10.2025 (lista e aseteve bashkëlidhur).

2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 nuk e çliron shoqërinë “Erseka Solar Park 1”



sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohej nga këto organe.

3. Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës sigurose mbi asetet e paluajtshme të saj që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm, si dhe në rast të çdo ndryshimi në këtë marrëveshje, përfshirë transferimin tek të tretët.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria dokumenton heqjen e barrës sigurose të radhës së parë të vendosur mbi asetet e saj apo depozitohet ndonjë dokument i ndryshëm nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

“LISTA MAKINERIE PAJISJE E SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 1” SH.P.K.

1. Panele fotovoltaike, shtesë vlerë aseti, *me vlerë 299,278,740.50 lekë;*

2. Auger – Pajisje shpimi + Pjesë shtesë, *me vlerë 1,515,698.40 lekë;*

3. Trakti Hyrës 110 kV në N/S Ersekë, *me vlerë 25,447,766.54 lekë;*

4. Linja elektrike 110 kV 3.7 km, *me vlerë 40,954,361.00 lekë;*

5. Trakti hyrës 110 kV i linjës N/S Starje-Ersekë, *me vlerë 10,916,568.94 lekë;*

6. Zbarat 110 kV N/St Ersekë, *me vlerë 3,062,487.31 lekë;*

7. Trakti 110 kV i Transformatorit të Fuqisë, *me vlerë 8,131,699.05 lekë;*

8. Sistemi i mbrojtjes, komandimit, kontrollit, sistemit SCADA, *me vlerë 62,232,851.45 lekë;*

9. Transformator Elektrik Jupiter 6000-K-H1, *me vlerë 48,173,107.81 lekë;*

10. Panele Diellore Fotovoltaike, *me vlerë 374,231,733.12 lekë;*

11. Struktura Konstruksione Metalike, *me vlerë 196,226,214.33 lekë;*

12. Invertera HUAWEI SUN2000-330KTL-H1, *me vlerë 58,455,820.50 lekë;*

13. Invertera HUAWEI SUN2000-330KTL-H1, *me vlerë 3,025,881.78 lekë;*

14. Pjesë të konstruksioneve metalike, *me vlerë 625,820.05 lekë;*

15. Struktura, shtesë vlerë aseti, *me vlerë 45,696,143.12 lekë;*

16. Transformator Elektrik JUPITER 6000-50kVA, *me vlerë 16,576,245.60 lekë;*

17. Transformator POWER 110/20kV, 40/50 MVA, *me vlerë 45,661,781.44 lekë;*

18. Cela Elektrike 20 KV (7 copë), *me vlerë 20,705,230.20 lekë;*

19. FV Sistem Telekomunikacioni, *me vlerë 2,456,500.00 lekë;*

20. Panele Diellore, *me vlerë 12,580,104.04 lekë;*

21. Boks Komunikimi SCADA, *me vlerë 4,480,156.49 lekë;*

22. Aparat Meteorologjik, *me vlerë 16,607,709.76 lekë;*

23. Aparat Meteorologjik SIEMENS, *me vlerë 4,344,709.60 lekë;*

24. Konvertitorë, *me vlerë 1,840,971.78 lekë;*

25. Panel SCADA, *me vlerë 5,772,669.99 lekë;*

26. Aparat Kontrolli për Impiante Fotovoltaike 237768.38, *me vlerë 951,073.55 lekë;*

27. Bulloneri, *me vlerë 867,604.54 lekë;*

28. Matës Energjie MK6ES 206700.4, *me vlerë 413,400.80 lekë;*

29. Transformator Fuqie 50-200KVA 1750000, *me vlerë 175,000.00 lekë.*

Vlera totale rezulton 1,311,408,051.67 (një miliard e treqind e njëmbëdhjetë milion e katërqind e tetë mijë e pesëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.

**VENDIM****Nr. 264, datë 21.10.2025****MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 199, DATË
15.8.2025, “PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT TË ERE-s PËR
VENDOSJEN E KUOTAVE TË
SHOQËRISË ‘RENEW’ SHPK, SI MJET
PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË
DETYRIMIT NDAJ ‘PROCREDIT
BANK’ SH.A.”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2157/10 prot., datë 16.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 199, datë 15.08.2025, mbi kërkesën e shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k për dhënie e autorizimit për barrësimin e kuotave të saj, me qëllim garantimin e shlyerjes së detyrimeve të lindura në favor të ‘Procredit Bank’ sh.a.”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Renew” sh.p.k

- Shoqëria “Renew” sh.p.k është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet 2 mw në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Ndërsa me vendimin nr. 199, datë 15.8.2025, Bordi i ERE-s, ka miratuar dhënie e autorizimit për barrësimin e kuotave të shoqërisë, me qëllim garantimin e shlyerjes së detyrimeve të lindura në favor të “Procredit Bank” sh.a., duke përcaktuar: 1. Dhënie e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Renew” sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Procredit Bank” sh.a. (sipas kontratave të kredive datë 19.3.2025). 2. Dhënie e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “Renew” sh.p.k. nga detyrimi për të

marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe. 3. Shoqëria “Renew” sh.p.k duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrimit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj. 4. Shoqëria “Renew” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm. 5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi.

- ERE me shkresën nr. 2157/4 prot., datë 15.8.2025, njoftoi shoqërinë për vendimin e sipërcituar, dhe i solli në vëmendje mbajtjen në konsideratë të plotësimit të kushteve të lëna në këtë vendim.

- Në kuadër të rakordimit të punës dhe të mbikëqyrjes së kushteve respektive është konstatuar nga ekstrakti historik i regjistrimit tregtar në faqen e QKB-së, se rezultoni e publikuar çështja në lidhje me depozitimin e Kontratës së Pengut, datë 19.3.2025 (nr. CN-522054-09-25), ndaj ERE me shkresën nr. 2157/8 prot., datë 25.9.2025, i solli në vëmendje detyrimin që kishte në zbatim të vendimit nr. 199/2025, e si e tillë i kërkoi shoqërisë depozitimin e tij, në mënyrë që të vijojë me rishikimin e kushtit të lënë në zbatim të vendimit.

2. Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Me shkresën nr. 2157/9 prot., datë 30.9.2025, shoqëria ka sqaruar se ka vijuar me regjistrimin e kontratës së pengut në QKB dhe ka përcjellë në ERE ekstraktin historik të përditësuar, të datës 25.9.2025.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Duke marrë në konsideratë përcaktimet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 199, datë 15.8.2025, rezultoni i përmbushur kushti i parashikuar në pikën 3 të këtij vendimi.

- ERE është informuar nëpërmjet shkresës datë 30.9.2025, ku shoqëria ka sqaruar se kontrata e pengut është regjistruar në QKB dhe ka përcjellë në ERE ekstraktin historik të saj me këtë pasqyrim.

- Në këto kushte, vlerësohet se pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 199, datë 15.8.2025, duhet të shfuqizohet, pasi objekti i saj është përmbushur dhe nuk ka më nevojë për ndjekje të mëtejshme institucionale.



- Gjithashtu, me shfuqizimin e pikës 3 të vendimit të Bordit nr. 199/2025, lind nevoja dhe për ndryshimin e pikës 5 të këtij vendimi nga “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi në “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 4 të këtij vendimi”.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet nga organi publik që ka kompetencën për ta nxjerrë, vlerësohet se pika 3 e vendimit të Bordit të ERE nr. 199, datë 15.8.2025, duhet të shfuqizohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE nr. 199, datë 15.8.2025, shfuqizohet.

2. Pika 5 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 199, datë 15.8.2025, ndryshon si më poshtë vijon:

“Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 4 të këtij vendimi.”

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Renew” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 272, datë 31.10.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, dhe nenit 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2478/5 prot., datë 27.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GSA Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “GSA Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2478 prot., datë 18.9.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 242, datë 30.9.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.10.2025 dhe 2.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 2478/3 prot., datë 3.10.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2478/4 prot., datë 10.10.2025, shoqëria ka



depozituar informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Nga përmbajtja e vendimit të organeve drejtuese të shoqërisë “GSA Energy” sh.p.k., rezulton se angazhimi për vendosjen në dispozicion të stafit teknik dhe mjeteve financiare për ushtrimin e veprimtarisë është marrë nga shoqëria mëmë. Si e tillë vlerësohet që, në kuadër të raportimeve përkatëse, t’i lihet detyrë shoqërisë të depozitojë në ERE vendimin e korigjuar, ku të shprehet angazhimi përkatës.

- Shoqëria i disponon aktualisht zyrat përfaqësuese të furnizuesit, por duke qenë se afati i kontratës së qirasë përfundon më 1.6.2030 dhe nuk mbulon afatin 5-vjeçar të licencës, vlerësohet t’i lihet kusht shoqërisë që brenda kësaj date të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GSA Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Brenda datës 1.6.2030, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të pikës 2.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “GSA Energy” sh.p.k., “OST” sh.a., “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 273, datë 31.10.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2472/4 prot., datë 27.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GSA Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “GSA Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2477 prot., datë 18.9.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 243, datë 30.9.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.



- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.10.2025 dhe 2.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 2477/3 prot., datë 3.10.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2477/4 prot., datë 10.10.2025, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Nga përmbajtja e vendimit të organeve drejtuese të shoqërisë “GSA Energy” sh.p.k., rezulton se angazhimi për vendosjen në dispozicion të stafit teknik dhe mjeteve financiare për ushtrimin e veprimtarisë është marrë nga shoqëria mëmë. Si e tillë vlerësohet që, në kuadër të raportimeve përkatëse, t’i lihet detyrë shoqërisë të depozitojë në ERE vendimin e korigjuar, ku të shprehet angazhimi përkatës.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GSA Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “GSA Energy” sh.p.k., “OST” sh.a., “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data

e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 274, datë 31.10.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 2” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “BANKA E PARË E INVESTIMEVE – ALBANIA” SHA DHE “FIRST INVESTMENT BANK AD” SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2572/4 prot., datë 27.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Erseka Solar Park 2’ sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “Erseka Solar Park 2”



sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën nr. 2572 prot., datë 3.10.2025, ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga Enti Rregullator i Energjisë për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a. dhe “First Investment Bank AD”, Sofie, Bullgari, ku Agjent i Kredisë është zgjedhur “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.8.2023, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet prodhimi 20 mw, zona Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë.

- ERE, me shkresën nëpërmjet shkresës nr. 2572/1 prot., datë 14.10.2025, i ka bërë me dije dokumentacionin e pa plotësuar/plotësuar pjesërisht për këtë aplikim.

3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Shoqëria, me shkresat me nr. 2572/2 prot., datë 16.10.2025 dhe nr. 2572/3 prot., datë 16.10.2025, ka përcjellë të plotë dokumentacionin/informacionin e kërkuar.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- neni 5, pika 2 – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- neni 5, pika 4 – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike;

- neni 5, pika 5 – shoqëria nuk ka paraqitur asnjë kërkesë që dokumentacioni të mos jetë i hapur për publikim, ndaj konsiderohet se nuk e kërkon këtë kufizim.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- pika 1 – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës siguruese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave;

- pika 2 – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- germa “a” – ekstrakti historik i regjistrit tregtar;

- germa “b” – vendimi i organeve drejtuese: është depozituar vendimi i “Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë ‘Erseka Solar Park 2’ sh.p.k., ku miratohet vendosja e barrës siguruese mbi kuotat si mjet për garantimin e shlyerjes së kredisë bankare”;

- germa “c” – marrëveshjen përkatëse:

- “Kontratën e kredisë bankare” me nr. 3298 rep., nr. 1375 kol., datë 1.10.2025, nënshkruar nga palët, ku rezulton që qëllimi i përdorimit të kredisë është ndërtimi i parkut energjetik fotovoltaike të “Erseka Solar Park 2” sh.p.k.

- “Marrëveshjen siguruese” nr. 3299 rep., nr. 1376 kol., datë 1.10.2025, nënshkruar nga palët, ku objekti i saj është vendosja në favor të bankave 100% të kuotave të kapitalit themeltar nga ortakët e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k.;

- Pika 3 – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria



ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja është nënshkruar me bankë vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Në referencë të nenit 9, pika 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për vendosjen e kuotave/ aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrimit tregtar të QKB-së nga ku të reflektohet ky ndryshim/transferim.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënie e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a. dhe “First Investment Bank AD” sh.a., ku Agjent i Kredisë është zgjedhur “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a. (sipas kontratës së kredisë nr. 3298 rep., nr. 1375 kol., datë 1.10.2025 dhe marrëveshjes siguruese nr. 3299 rep., nr. 1376 kol., datë 1.10.2025).

2. Dhënie e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në zbatim të pikave 2 dhe 3, si dhe në rast se nga MIE depozitohet një qëndrim ndryshe, në lidhje me kërkesën e bërë nga shoqëria lidhur me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga kontrata e nënshkruar me MIE-n, datë 13.1.2023 apo çdo akt tjetër i ndryshuar që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 275, datë 31.10.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “AGE ERZEN” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “BANKA OTP ALBANIA” SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2430/11 prot., datë 27.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Age Erzen’ sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj,



si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Age Erzen” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria me shkresën nr. 2430 prot., datë 9.9.2025, ka paraqitur kërkesë për marrjen e miratimit për barrësimin e kuotave, në lidhje me garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Age Erzen” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 154, datë 31.7.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hekali”, me kapacitet të instaluar 1940 kw.

- ERE me shkresën nr. 2430/1 prot., datë 10.9.2025, i ka bërë me dije shoqërisë se duhet të depozitojë sa kërkuar, referuar nenit 8, të rregullores nr. 235/2021 në fuqi, kurse me shkresat nr. 2430/4 prot., datë 3.10.2025 dhe *email*-in e datës 16.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2430/7 port., datë 16.10.2025, i ka bërë me dije dokumentacionin e pa plotësuar/plotësuar pjesërisht për këtë aplikim.

3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Me shkresën nr. 2430/2 prot., datë 22.9.2025, ka përcjellë informacion/dokumentacion plotësues, ndërsa me shkresat nr. 2430/5 prot., datë 8.10.2025, nr. 2430/8 prot., datë 17.10.2025 dhe nr. 2430/9 prot., datë 24.10.2025, shoqëria ka përcjellë të plotë dokumentacionin e kërkuar.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Age Erzen” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me

vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- Neni 5, pika 2 – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4 – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike;

- Neni 5, pika 5 – shoqëria nuk ka paraqitur asnjë kërkesë që dokumentacioni të mos jetë i hapur për publikim, ndaj konsiderohet se nuk e kërkon këtë kufizim.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- Pika 1 – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës sigurorese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave;

- Pika 2 – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- Germa “a” – ekstrakti historik i regjistrit tregtar;

- Germa “b” – vendimi i organeve drejtuese: ka depozituar vendimin e Asamblesë së Ortakut të vetëm të shoqërisë “Age Erzen” sh.p.k., datë 6.10.2025 dhe datë 22.10.2025, nëpërmjet të cilëve shprehet dakordësia mbi vendosjen e kuotave të kësaj shoqërie, si garanci për shlyerjen e detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a.

- Germa “c” – marrëveshjen përkatëse:

- “Kontratë kredie (kontratë kredi bankare)” nr. 7825 rep., nr. 3593 kol., datë 9.9.2024 dhe “Kontratë kredie (kontratë kredi bankare)” nr. 1036 rep., nr. 435 kol., datë 23.10.2025, nënshkruar midis palëve, e cila do të përdoret nga kredimarrësi për financimin e projektit për makineri dhe pajisje dhe për investime në asete fikse.

- “Marrëveshjen e barrës sigurorese kuota/aksione” nr. 7827 rep., nr. 3595 kol., datë 9.9.2024 dhe “Marrëveshjen e barrës sigurorese kuota/aksione” nr. 1040 rep., nr. 439 kol., datë 23.10.2025, të nënshkruara midis palëve ku është rënë dakord të barrësohen 100% të kuotave, me qëllim për të garantuar përmbushjen e detyrimeve të garantuara të përcaktuara në kontratat e kredisë më sipër cituar.

- Pika 3 – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

**6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit**

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Age Erzen” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja është nënshkruar me bankë vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Në referencë të nenit 9, pika 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së ku të reflektohet ndryshimi/transferimi në lidhje me marrëveshjen siguruese nr. 1040 rep., nr. 439 kol., datë 23.10.2025, pasi sa konstatuar rezulton se shoqëria ka pasqyruar vetëm marrëveshjen siguruese me nr. 7827 rep., nr. 3595 kol., datë 9.9.2024.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Age Erzen” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a. (sipas kontratave të kredisë nr. 7825 rep., nr. 3593 kol., datë 9.9.2024; nr. 1036 rep., nr. 435 kol., datë 23.10.2025, si dhe marrëveshjeve siguruese me nr. 7827 rep., nr. 3595 kol., datë 9.9.2024; nr. 1040 rep., nr. 439 kol., datë 23.10.2025).

2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “Age Erzen” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “Age Erzen” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikës 3, si dhe në rast se nga MIE depozitohet një qëndrim ndryshe në lidhje me kërkesën e bërë nga shoqëria lidhur me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga kontrata e nënshkruar me MIE-n datë 3.12.2020, apo çdo akt tjetër i ndryshuar që i ka shërbyer kësaj vendimmarrjeje.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Age Erzen” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 721/11, datë 3.11.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim depo në zonën e Qytetit të Nxënësve”, me vendndodhje Tiranë. Subjekti kërkues i këtij projekti është Ujësjiellës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë pronë private, sipas vlerësimit paraprak të



llogaritur, për pasuritë e llojit “Ullishtë”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 1,431,283.84 (një milion e katërqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre pikë tetëdhjetë e katër) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren

Zyrtare kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI “NDËRTIM DEPO NË ZONËN E QYTETIT TË NXËNËSVE”, ME VENDNDODHJE TIRANË

Nr.	TË DHËNAT E PRONËSISË			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM, SIPAS LLOJIT TË PASURISË				SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Arë (m²)	Truall (m²)	ULLISHTJE			VLERA TOTALE	
											Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)		
1	Esat Violeta	Fevri Fevri	Pazari Pazari	Tiranë	3292	57/2	Ullishte	5,000			166.67	448	74,668.16	74,668.16	Bllokohet, debitor VEFA
2	Isidor	Stavri	Rudho	Tiranë	3292	51/158	Ullishte	10,311.60			84.1	448	37,676.80	37,676.80	
3	Violeta	Fevri	Pazari	Tiranë	3292	60/29	Ullishte	5,200			304.3	448	136,326.40	136,326.40	Bllokohet, debitor VEFA
4	Esat Violeta	Fevri Fevri	Pazari Pazari	Tiranë	3292	51/283	Ullishte	49,781.6			2,639.76	448	1,182,612.48	1,182,612.48	Mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa me nr. 51/253-ND9 Vol. 78, f.184, l. leg.
Shuma paraprake														1,431,283.84	

KËRKESË

Nr. 1063/5, datë 4.11.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 534, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtim rruga Porto-Romano–Durrës, loti 3’”, i ndryshuar.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 296,940 lekë (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzet lekë), vlerësimi i pasurisë së llojit “arë” është përlogaritur referuar pikës 5, të VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të

pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë të cilët preken por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit, në lidhje me projektin e sipërcituar, është 296,940 lekë (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzet) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIM RRUGA PORTO-ROMANO–DURRËS, LOTI 3”, I NDRYSHUAR

Nr.	Pronari			ZK	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi lekë/m ²	Vlera (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Rahim	Hamit	Bardhoci	8517	38/27	5650	are	707	420	296,940.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.
	Shuma									296,940.00	



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 400 lekë

